FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.149 10 nëntor 2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 467 datë 6.10.2011	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile në Shqipëri".....	6869
Ligj nr.10 471 datë 20.10.2011	Për ratifikimin e "Marrëveshjes së kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Unicredit Bank Austria AG për financimin e projektit "Furnizimi me ujë i Bilishtit-kontratë me çelësa në dorë""	6875
Ligj nr.10 472 datë 20.10.2011	Për ratifikimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave"	6893
Udhëzim i KM nr.3, datë 5.10.2011	Për procedurat e regjistrimit të objekteve, të ndërtuara me leje ndërtimi të prapambetura në Bashkinë e Tiranës, në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	6904

LIGJ
Nr.10 467, datë 6.10.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDRYSHUESE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË PËR REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIK PËR REGJISTRIN THEMELTAR TË GJENDJES CIVILE NË SHQIPËRI"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndryshuese ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për realizimin e një sistemi kompjuterik për Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile në Shqipëri".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7130, datë 25.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

SHTESË E MARRËVESHJES
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË AUSTRISË, PËR REALIZIMIN E NJË SISTEMI KOMPJUTERIK PËR REGJISTRIN THEMELTAR TË GJENDJES CIVILE NË SHQIPËRI

Të përgjithshme

Kjo shtesë bazohet në rregullat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga Marrëveshja e nënshkruar më 25 qershor 2008 në Tiranë ndërmjet Ministrisë Federale të Brendshme të Austrisë dhe Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë në lidhje me implementimin e Regjistrit Kombëtar Civil.

Përshkrimi

Qëllimi i kësaj shtese është dhënia e të drejtave shtesë autoritetit kontraktues lidhur me paketën *software* të quajtur "Solution ZMR", e cila është një pjesë integrale e paketës *software* të quajtur "Regjistri Kombëtar Civil (RKC)" për qëllim të lejimit të autoritetit kontraktues për shitjen e RKC-së.

Shërbimet e mbështetjes operacionale për Regjistrin Kombëtar Civil aktualisht kryhen nga XION IT System AG. Autoriteti kontraktues do ta caktojë këtë kompani për të siguruar vazhdimësinë dhe përmirësimin e plotë operacional të sistemit *software* për RKC-në në Shqipëri për tri vitet në vazhdim duke filluar që nga 1 janari 2011, përkundrejt pagesës. Kjo kontratë do të vazhdojë në mënyrë automatike edhe për një vit tjetër nëse nuk do të prishet nga njëra palë të paktën deri në fund të tremujorit të tretë të vitit.

Shërbimet

Kompania e kualifikuar e caktuar do të ofrojë shërbimet e mëposhtme:

- Mbështetjen operacionale IT;
- Mirëmbajtjen e *software*-it;

Mbështetjen operacionale IT.

- Faza transitore për marrjen në ngarkim të mbështetjes operacionale të nivelit të parë nga Ministria e Brendshme e Shqipërisë. Kjo fazë është e planifikuar për 9-mujorin e parë të 2011-s. Do të sigurohet një shërbim mbështetës siç aktualisht është për këtë mbështetje operacionale të nivelit të parë.

- Një mbështetje operacionale e nivelit të dytë do të sigurohet gjatë gjithë periudhës së kontratës. Ky grup ekspertësh do të punojnë në Vjenë por do të jetë i lidhur *online* me sistemin RKC në Shqipëri, dhe do të ketë, gjithashtu, një komunikim *online* me nivelin e parë të mbështetjes operacionale në vend. Nëse do të jetë e nevojshme (p.sh. ndryshime të rëndësishme në sistem, në rastet e emergjencave të veçanta), këta ekspertë do të asistojnë dhe mbështesin specialistët e MB në terren në Tiranë.

- Paralelisht, Ministria e Brendshme e Shqipërisë do të fillojë implementimin e proceseve të shërbimit ITIL për RKC-në. Ky është një nga faktorët më të rëndësishëm kritikë të suksesit për vendosjen e një operimi të mirë të sistemit. Për këtë qëllim do të sigurohet një mbështetje në vend për Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë me ekspertë të specializuar. Veçanërisht instalimi i proceseve të shërbimit ITIL do të rrisë efiçencën dhe sigurinë e sistemit të RKC-së dhe do të çojë operimin e Ministrisë së Brendshme të Shqipërisë drejt standardeve ndërkombëtare, dhe do të jetë një bazë e qëndrueshme për zhvillime të mëtejshme për funksionimin dhe rritjen e sistemit të RKC-së.

- Instalimi dhe mbështetja operacionale e vazhdueshme për sistemin *cluster,* duke përfshirë mbështetjen operacionale të nivelit të dytë përgjatë gjithë periudhës së kontratës.

- Mbështetja operacionale IT shpjegohet më në detaje në aneksin 1 të kësaj shtesë marrëveshjeje.

Mirëmbajtja e *software*-it

- Për të siguruar shërbimet për vazhdimësinë dhe përmirësimin e RKC-së në Shqipëri, kompania e kualifikuar e caktuar do të sigurojë deri në 2000 orë të specialistëve të *software*-it të kualifikuar për RKC-në në vit. Bazuar për implementimin e procesit të shërbimit *ITIL* "kërkesë për ndryshim" dhe instalimin e "Bordit këshillues të kërkesave për ndryshim", Ministria e Brendshme e Shqipërisë do të jetë në gjendje të menaxhojë dhe kontrollojë detyrat konkrete të mirëmbajtjes dhe përdorimin e burimeve të siguruara të mirëmbajtjes.

- Mirëmbajtja e *software*-it përfshin të gjitha aktivitetet, të cilat lidhen me modifikimin e aplikimeve në përdorim:

- Të rregullojë defektet;
- Të përmirësojë performancën dhe cilësitë e tjera;
- Të përmirësojë aplikimin; ose
- Të adoptojë ndryshimet e kushteve; dhe
- Zhvillimin e funksionaliteteve të reja.

- Mirëmbajtja e *software*-it shpjegohet më në detaje në aneksin 1 të kësaj shtesë marrëveshjeje.

Të drejtat e *software*-it

- Sipas nenit 14 të marrëveshjes origjinale, garancia për modulet e adoptuara përfundon 2 vjet pas miratimit më 18 nëntor 2010. Detyrimi i kontraktorit përfundon menjëherë me ndryshimin e parë të kodit burim nga kompania e kualifikuar e caktuar. Kodi burim dhe dokumentacioni do t'i dorëzohen autoritetit kontraktues.

- Në ndryshimin e nenit 4 të marrëveshjes origjinale, kontraktori do t'i transferojë të drejtat e transferueshme të "Solution ZMR" si pjesë e Regjistrit Kombëtar Civil, RKC, autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues do të transferojë të drejtat e pakufizuara ekskluzive dhe të transferuese për marketing dhe shitjen e zgjidhjes RKC jashtë Shqipërisë, bazuar në kufijtë gjeografikë në kohën e nënshkrimit të kësaj kontrate kompanisë së kualifikuar të caktuar. Pagesat e licencës do të ndahen midis autoritetit kontraktues dhe kontraktuesit. Pagesat e licencës për vend nuk mund të jenë më pak se 1 000 000 euro.

Pagesa e licencës që i takon kontraktuesit (50% e tarifës së plotë të licencës) është e pagueshme 14 ditë pas lidhjes së marrëveshjes së licencimit dhe bëhet në llogarinë si vijon:

Numri i llogarisë bankare:	5020009
Kodi bankar:	60000
Qëllimi:	2110848173005

Pagesa

Pagesa për shërbimet e dhëna nga kompania e kualifikuar, e caktuar nga Ministria Federale e Brendshme e Austrisë do të jetë:

- € 350 000 - për mbështetjen IT;

- € 150 000 - për mirëmbajtje *software në vit duke përfshirë shpenzimet e udhëtimeve,* përjashtuar TVSH-në në Shqipëri.

Data e pagesës

Pagesa për këto shërbime të siguruara nga kompania e kualifikuar e caktuar do të parapaguhet çdo tre muaj.

Tiranë, nëntor 2010.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË AUSTRISË	PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Kontraktori	**Autoriteti kontraktues**

ANEKSI 1
QËLLIMI I SHËRBIMIT TË MBËSHTETJES IT

Niveli i dytë i mbështetjes operacionale

Menaxhimi i vlefshmërisë:

- Matja, administrimi, raportimi e vlefshmërisë së shërbimeve;
- Pastrimi i *data base* në prodhim;
- Pastrimi i *data base* në test.

Menaxhimi i versioneve dhe instalimeve:

- Përgatitja e mjedisit të trajnimit/testimit;
- Menaxhimi operacional në prodhim (implementimi i migrimit të të dhënave, transferimi i operimit...);

- Menaxhimi operacional në test (implementimi i migrimit të të dhënave, transferimi i operimit...).

Vlefshmëria e shërbimit dhe testimi:
- Sigurimi i cilësisë së modelit të të dhënave;
- Mirëmbajtja e sistemeve të testimit;
- Testimi i ngarkesës dhe performancës;

Menaxhimi i ngjarjeve:
- Mbështetja e nivelit të dytë (teknikisht);
- Mbështetja teknike e zhvilluesve në prodhim;
- Mbështetja teknike e zhvilluesve në test;
- Mbështetja metodologjike e zhvilluesve.

Mbështetja e prodhimit:
- Përpunimi *batch* në prodhim;
- Përpunimi *batch* në test;
- Monitorimi i shërbimeve të përgjithshme;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës në prodhim;
- Mirëmbajtja e infrastrukturës në test;
- Administrimi i *data base* në prodhim;
- Administrimi i *data base* në test.

Menaxhimi i të drejtave të hyrjes:
- Administrimi i të drejtave të zhvilluesve dhe menaxhimi i përdoruesve në test;
- Menaxhimi i autorizimeve në prodhim;
- Menaxhimi i autorizimeve në test;
- Përcaktimi i roleve;
- Menaxhimi i sigurisë.

Mbështetja e implementimit të procesit të shërbimit
Ndërton një plan implementimi të mirë për proceset e shërbimit;
Përcakton prioritetet e implementimit;
Për çdo proces:
- Dizenjon procesin;
- Përcakton rolet, përgjegjësitë dhe objektivat;
- Përcakton pritshmërinë;
- Përgatit ndryshimet kulturore;
- Përcakton pronësinë e roleve;
- Mbledhjet e implementimit;
- Materiali i implementimit;
- Kontrolli i statusit të implementimit;
- Akordimin e implementimit;

Raportet e menaxhimit të statusit rreth procesit të implementimit
Proceset e strategjisë së shërbimit:
- Menaxhimi i gjenerimit të strategjive;
- Menaxhimi i portofolit të shërbimeve;
- Menaxhimi financiar;
- Menaxhimi i kërkesës.

Proceset e dizajnit të shërbimit:
- Menaxhimi i katalogut të shërbimit;

- Menaxhimi i nivelit të shërbimit;
- Menaxhimi i kapaciteteve;
- Menaxhimi i vlefshmërisë;
- Menaxhimi i vazhdimësisë së shërbimeve të IT-së;
- Menaxhimi i sigurimit të informacionit;
- Menaxhimi i furnizimit.

Procesi i shërbimeve transitore:
- Planifikimi dhe mbështetja transitore;
- Menaxhim ndryshimi;
- Vlefshmëria e shërbimit dhe testimi;
- Menaxhimi dhe komunikimi i palëve të interesuara.

Proceset e shërbimit operativ:
- Menaxhimi i ngjarjeve.

Proceset e vazhdueshme të përmirësimit të shërbimit:
- Matjet e shërbimit;
- Raportimi i shërbimit;
- Përmirësimet e vazhdueshme të shërbimit dhe menaxhimi i nivelit të shërbimit.

Përshkrimi teknik i instalimit *cluster* të RKC

Parakushtet:

- Me qëllim që të lehtësojnë një instalim *cluster* në prodhim, janë të nevojshme pikat e mëposhtme:

- Siguron të njëjtin konfigurim *hardware* si ai në memorien e vendndodhjes tjetër dhe të mjaftueshëm, CPU dhe hapësirë ruajtjeje të mjaftueshme për ndarjet;
- *Hardware*-i është i rregulluar dhe operativ, duke përfshirë furnizimin me energji elektrike;
- Nëse hardueri nuk është në të njëjtën vendndodhje kërkohet një HMC i dytë;
- Vendoset një stacion monitorimi i dytë për një *cluster* dhe operacionet;
- Ka të paktën një lidhje rrjeti me vendndodhjet e tjera (TCP/IP minimumi 100MB/s rekomandohet 1GB/s) dhe stacionin e punës për stafin operativ;
- Pajisje të mjaftueshme rrjeti (RJ45 dhe kabllo FC);
- Akses fizik në sistem.

Instalimi virtual i ndarjes, lloji 1:
- Instalimi i profilit LPAR në *hardware* P6;
- Instalimi i adaptorëve virtualë dhe disqeve;
- Instalimi i burimeve në serverin VIO;
- Instalim i ndarjes (mksysb, ruajtja-konfigurimi pa rrjet);
- Konfigurimi i rrjetit;
- Konfigurimi i serverit të ndërmjetëm (duke përfshirë ndarjen ekzistuese);
- Konfigurimi i softit të ndërmjetëm;
- Konfigurimi i kopjes rezervë;
- Konfigurimi i monitorimit;
- Dokumentimi i ndarjes;
- Fillimi i operimit *cluster* pas orës 22:00.

Instalimi virtual i ndarjes, lloji 2:
- Instalimi i profilit LPAR në *hardware* P6;
- Instalimi i adaptorëve virtualë dhe disqeve;
- Instalimi i burimeve në serverin VIO;
- Instalimi i ndarjes (mksysb, ruajtja-konfigurimi pa rrjet);

- Konfigurimi i rrjetit;
- Konfigurimi i serverit-HACMP (duke përfshirë ndarjen ekzistuese);
- Konfigurimi i kopjes rezervë;
- Konfigurimi i monitorimit;
- Testimi i HACMP-Cluster;
- Dokumentimi i ndarjes;
- Fillimi i operimit *cluster* pas orës 22:00;

Instalimi virtual i ndarjes, lloji 3:
- Instalimi i profilit LPAR në *hardware* P6;
- Instalimi i serverit VIO;
- Konfigurimi i rrjetit;
- Konfigurimi SAN;
- Alokimi i të dhënave të ruajtura në SAN;
- Konfigurimi i VIOS;
- Dokumentimi i ndarjes;

Instalimi i HMC:
- Konfigurimi HMC;
- Integrimi i sistemeve të menaxhuara të serisë P në HMC;

Instalimi i *cluster* të monitorimit:
- Instalimi i sistemit të bazuar në *linux*;
- Konfigurimi i rrjetit;
- Konfigurimi i monitorimit;
- Konfigurimi *cluster* (duke përfshirë serverin ekzistues);
- Instalimi dhe konfigurimi i shërbimeve të sistemeve operative;

Instalimi i *cluster* të RKC:
- Konfigurimi i WAS *cluster*;
- Fillimi i operimit *cluster* të RKC-së pas 22:00;
- Konfigurimi i monitorimit;

I papërfshirë

Testimi i mjedisit si një *cluster*

Mirëmbajtja e *software*

a) Mirëmbajtja e adaptuar e *software*

Mirëmbajtja e adaptuar e *software*-it përfshin të gjitha aktivitetet që kanë të bëjnë me ndryshimin e kushteve mjedisore. Këto kushte mjedisore mund të jenë p.sh. ndryshimet legjislative, ndryshimet organizative dhe ndryshimet e ndërfaqes. Çdo ndryshim i tillë nuk do të krijojë një vlerë funksionale për përdoruesit fundorë.

b) Mirëmbajtja korrigjuese e *software*

Mirëmbajtja korrigjuese e *software* përfshin të gjitha aktivitetet e nevojshme për të korrigjuar mangësitë. Këtu, ndërmjet mirëmbajtjes - riparimit të defekteve të rënda dhe korrigjimit të mangësive, heqjen e defekteve të mesme dhe të lehta janë të dallueshme.

Në kontrast me korrigjimin e mangësive të parashikueshme, masat e mirëmbajtjes duhen të zbatohen menjëherë, në mënyrë që të ruhet funksionimi i aplikimit.

c) Mirëmbajtja optimizuese e *software*-it

Mirëmbajtja optimizuese e *software*-it përfshin të gjitha aktivitetet për të përmirësuar punën e aplikimit dhe për të përmirësuar vetitë e aplikimit. Masat për të përmirësuar punën e aplikimit mund të jenë, për shembull, ulja e kohës së përgjigjes dhe reduktimi i ngarkesës së sistemit dhe të konsumit të memories. Përmirësimi i vetive mund t'i përkasë, për shembull, ndërfaqes së

përdoruesit, modeli i të dhënave ose arkitektura e sistemit, performanca teknike e programit nuk mund të ndikohet.

d) Mirëmbajtja zgjeruese e *software*-it

Mirëmbajtja zgjeruese e *software*-it përfshin të gjitha aktivitetet për të zgjeruar funksionalitetin e aplikacionit (p.sh. ndërfaqe të reja për aplikacione të tjera, funksionalitete të reja të aplikimit, ndërfaqe e re për përdoruesit etj.).

Kategoritë për prioritetet e kërkesës për ndryshim:

a) Prioriteti 0

Çrregullime që janë të dëmshme për të operuar dhe kur operimi është aktualisht i përcaktuar, gabimi në këtë rast është prioriteti i parë dhe në të gjitha aktivitetet e tjera pavarësisht personave përkatës të prekur (zhvilluesit, personelit ndihmës). Alokimi i prioritetit 0 mund të bëhet vetëm nga një menaxher ndryshimi.

b) Prioriteti 1

Problemi është serioz dhe për momentin nuk po punohet për zgjidhjen e tij. Problemi nuk është i rrezikshëm për të operuar. Korrigjimi i ndërhyrjes duhet të bëhet sa më shpejt të jetë e mundur.

c) Prioriteti 2

Për këtë problem, po punohet për zgjidhjen e tij për departamentin, puna për zgjidhjen e tij është e vështirë, por e arsyeshme. Korrigjimi i ndërhyrjes bëhet në përputhje me projektplanin ekzistues.

d) Prioriteti 3

Për këtë çrregullim po punohet për një zgjidhje të arsyeshme, përpjekja për të korrigjuar gabimin është me përdorimin e lëshimit të versionit të radhës.

LIGJ
Nr.10 471, datë 20.10.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË KREDISË PËR EKSPORT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "FURNIZIMI ME UJË I BILISHTIT-KONTRATË ME ÇELËSA NË DORË""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e kredisë për eksport ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe UniCredit Bank Austria AG për financimin e projektit "Furnizimi me ujë i Bilishtit - kontratë me çelësa në dorë"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7144, datë 31.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE KREDIE PËR EKSPORT

HUA E BUTË NR. 230.409 PËR NJË SHUMË PREJ 7, 505, 420.80 EURO DATË ..... 2011 E LIDHUR NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË QË VEPRON NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE I PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE (SI "HUAMARRËSI") DHE UNICREDIT BANK AUSTRIA AG (SI "HUADHËNËSI") NË LIDHJE ME FINANCIMIN E "PROJEKTIT TË FURNIZIMIT ME UJË TË BILISHTIT-KONTRATË ME ÇELËSA NË DORË"

Kjo marrëveshje kredie për eksport për një hua të butë nr.230.409 në një shumë prej 7,505,420.80 euro (Marrëveshja) e datës ..... 2011 është lidhur ndërmjet Huamarrësit të përcaktuar në aneksin 1 (Huamarrësi) dhe Huadhënësit (Huadhënësi) të përcaktuar në aneksin 1.

1. PËRKUFIZIMET

Në këtë Marrëveshje dhe në anekset e saj shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet si më poshtë:

"Datë pranimi" nënkupton datën në të cilën kjo Marrëveshje është nënshkruar nga të dyja palët dhe është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë.

"Aneks" nënkupton një aneks të kësaj Marrëveshjeje, termat e të cilit konsiderohen të përfshira në këtë Marrëveshje dhe përbëjnë pjesë integrale të saj.

"Periudhë e disponueshmërisë" nënkupton periudhën e përcaktuar në aneksin 3, gjatë së cilës huamarrjet mund të tërhiqen nga shuma e kredisë.

"Huamarrje" nënkupton një shumë të tërhequr nga Huamarrësi nga shuma e kredisë.

"Ditë pune" nënkupton një ditë në të cilën bankat janë të hapura për punë dhe transaksionet dhe depozita në valutë të huaj midis bankave mund të kryhen në Vjenë dhe Tiranë.

"Datë e mbylljes" nënkupton datën e përcaktuar në seksionin 7 të kësaj Marrëveshjeje.

"Shuma e kredisë" nënkupton shumën e përcaktuar në aneksin 3, nga e cila Huamarrësi mund të tërheqë huamarrje gjatë periudhës së disponueshmërisë.

"Euro" ose "€" monedha e vetme e shteteve anëtare të Bashkimit Europian që miratojnë euron si monedhën e tyre, në pajtim me legjislacionin e Komunitetit Europian në lidhje me Bashkimin Monetar dhe Ekonomik Europian.

"Euribor" nënkupton nivelin e përqindjes në vit të barabartë me vlerën aktuale mbi bazën e marrëveshjes 365/360 të mesatares së normës së depozitave Euribor, të miratuara me Euribor FBE (faqe 248) për një periudhë të barabartë me periudhën për të cilën interesi duhet të caktohet nga Huadhënësi (seksioni 3.3), në ose rreth orës 11:00 të Brukselit në ditën e dytë të punës para fillimit të periudhës përkatëse të interesit. Në këtë kontekst, "FBE" nënkupton "Federation Bancaire Europeenne" (Federata Bankare Europiane).

"Llogari e huas" nënkupton llogarinë e hapur në emër të Huamarrësit, në pajtim me dispozitat e seksionit 2.3.

"Data të pagesës së interesit" nënkupton datat 31 mars, 30 qershor, 30 shtator dhe 31 dhjetor të çdo viti, me kusht që, nëse një nga këto data nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

"Periudhë interesi" nënkupton një periudhë:

i) që fillon në datën e huamarrjes ose në ditën e fundit të periudhës së saj të mëparshme të interesit; dhe

ii) që përfundon më 31 mars, 30 qershor, 30 shtator ose 31 dhjetor të çdo viti.

"E drejta e barrës" nënkupton çdo hipotekë, tarifë, peng, barrë, hipotekim, detyrim, ruajtje titulli ose çdo interes tjetër garancie të çdo lloji dhe që ka lindur në çdo lloj mënyre.

"Hua" nënkupton shumën e përgjithshme të principalit të huamarrjeve të tërhequr sipas shumës së kredisë dhe ende të papaguara.

"Data të shlyerjes së detyrueshme" nënkupton datat në çdo vit, të përcaktuara në aneksin 3, me kusht që nëse një nga këto data nuk është ditë pune, referencat ndaj kësaj date do të jenë ndaj ditës më të afërt pararendëse të punës.

"OeKB" nënkupton Oesterreichische Kontrollbank Aktiengesellschaft, Am Hof 4, A-1011 Vienna, Austria, që vepron si agjenci kredie për eksport për dhe në emër të Republikës së Austrisë.

"Garanci e OeKB-së" nënkupton një garanci të lëshuar nga OeKB-ja si agjent i Republikës së Austrisë.

"Procedurë pagese" nënkupton procedurën për pagesën e huamarrjeve të përcaktuara në aneksin 4.

"Projekt" nënkupton projektin e përcaktuar në aneksin 2.

"Blerës i projektit" nënkupton Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Tiranë, Republika e Shqipërisë.

"Eksportues i projektit" nënkupton Duktus Tiroler Rohrensysteme CmbH, Hall in Tirol, Austria.

"Datë e pranimit të përkohshëm" nënkupton datën në të cilën Huadhënësi ka marrë nga eksportuesi i projektit kopjen e faturës nr.83 ("Dëftesa e marrjes përfundimtare në dorëzim" që përcaktohet në Marrëveshjen e blerjes).

"Marrëveshje blerjeje" nënkupton marrëveshjen mbi projektin të lidhur ndërmjet eksportuesit të projektit dhe blerësit të projektit dhe të përcaktuar në aneksin 2.

"Seksion" nënkupton një seksion të kësaj Marrëveshjeje.

2. SHUMA E KREDISË

2.1 Hyrje

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të përcaktojë termat dhe kushtet, në bazë të të cilëve Huadhënësi do të financojë 100 % të vlerës totale të kontratës (por deri në shumën maksimale të përcaktuar si "Shuma e kredisë" në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje), e cila duhet të paguhet nga blerësi i projektit për eksportuesin e projektit sipas marrëveshjes së blerjes.

2.2 Shuma e kredisë

Huadhënësi bie dakord t'i vërë Huamarrësit në dispozicion shumën e kredisë gjatë periudhës së disponueshmërisë, në bazë të termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje, me kusht që një huamarrje mund të bëhet vetëm nga Huamarrësi, sipas shumës së kredisë, në pajtim me procedurën e pagesës të përcaktuar në aneksin 4 dhe zbatohet për pagesën e çmimit të kërkueshëm ndaj eksportuesit të projektit sipas Marrëveshjes së blerjes.

Kredia e dhënë sipas kësaj Marrëveshjeje jepet sipas dhe në pajtim me dispozitat e rregullave dhe rregulloreve për kreditë e eksportit të shpallura nga Republika e Austrisë. Huamarrësi vlerëson se financimi mbështetet nga fondet e ndihmës publike me një element grandi prej 35.23 % (tridhjetë e pesë pikë njëzet e tre për qind).

Huadhënësi mund të refuzojë disbursimin e një huamarrjeje, nëse kjo huamarrje dhe interesi mbi të nuk do të mbuloheshin nga garancia e lëshuar nga OeKB për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në pajtim me ligjin mbi promovimin e eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, dhe/ose marrëveshja e rifinancimit me OeKB-në për shumën e kredisë pushon së qenuri në fuqi.

2.3 Llogaria e huas

Huadhënësi hap një llogari në euro në emër të Huamarrësit, e caktuar si "Llogaria e huas". Çdo huamarrje e bërë sipas kësaj Marrëveshjeje debitohet në llogarinë e huas, në pajtim me këtë Marrëveshje, me vlerë në datën e pagesës të kësaj huamarrjeje. Shlyerjet dhe parapagesat aplikohen përkatësisht në llogarinë e huas.

2.4 Pavarësia e Marrëveshjes dhe e Marrëveshjes së blerjes

Kjo Marrëveshje dhe Marrëveshja e blerjes janë marrëveshje të veçanta dhe të pavarura. Asnjë pamundësi e eksportuesit të projektit për të përmbushur detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së blerjes nuk cenon detyrimet e Huamarrësit ndaj Huadhënësit, as nuk e bën Huadhënësin përgjegjës për mosplotësimin e detyrimeve nga ana e eksportuesit të projektit dhe/ose ndonjë pale tjetër të Marrëveshjes së blerjes.

3. INTERESI

3.1 Interesi mbi llogarinë e huas

Huamarrësi paguan interes në datat e pagesës së interesit me një normë fikse, siç përcaktohet në aneksin 3, të llogaritur mbi shumën e papaguar të kredisë.

3.2 Llogaritja dhe data për pagesën e interesit

Interesi i kërkueshëm në pajtim me seksionin 3.1 rritet ditë pas dite, llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara për periudhën përkatëse të interesit dhe një vit prej 360 ditësh dhe përveç kur parashikohet në seksionin 6.1, do të paguhet çdo tre muaj pas afatit nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit.

3.3 Kamatëvonesa

Në rast të pamundësisë së Huamarrësit për të kryer në datën e duhur pagesën e çdo shume të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi do të paguajë interes mbi këtë shumë nga data e kësaj mospagese deri në datën e pagesës aktuale në normën e caktuar në aneksin 3. Kamatëvonesa sipas këtij seksioni 3.3 do të jetë e kërkueshme në datat e pagesës së interesit.

4. TARIFAT DHE SHPENZIMET

4.1 Tarifa e angazhimit

Për periudhën që fillon në datën e mbylljes dhe që mbaron në fund të periudhës së disponueshmërisë, Huamarrësi i paguan Huadhënësit një tarifë angazhimi në normën e caktuar në aneksin 3. Tarifa e angazhimit e kërkueshme në pajtim me këtë seksion 4.1 llogaritet mbi bazën e numrit aktual të ditëve të kaluara dhe një viti prej 360 ditësh nga Huadhënësi mbi balancën e patërhequr të shumës së kredisë në fillim të çdo tremujori kalendarik dhe paguhet pas afatit nga Huamarrësi për Huadhënësin në datat e pagesës së interesit. Pagesa e parë e tarifës së angazhimit sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhet në datën e pagesës së parë të interesit pas datës së mbylljes.

4.2 Tarifa e menaxhimit

Huamarrësi, brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune para disbursimit të parë të shumës së kredisë), do t'i paguajë Huadhënësit tarifën e menaxhimit të përcaktuar në aneksin 3.

4.3 Shpenzimet

i) Huamarrësi i paguan më tej Huadhënësit, me kërkesë, shpenzimet e arsyeshme dhe të dokumentuara (përfshirë shpenzimet ligjore, të përkthimit dhe të udhëtimit dhe shpenzimet mbi garancinë e OeKB-së) të bëra nga Huadhënësi në lidhje me padinë për kompensim të çdo shume të kërkueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje.

ii) Të gjitha taksat, tatimet, shpenzimet ose detyrimet e tjera të vendosura për Huadhënësin nga Ministria e Financave, Shqipëri, në lidhje me këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara sipas kësaj Marrëveshjeje, do të jenë për llogari të Huamarrësit dhe të pagueshme nga Huamarrësi për Huadhënësin.

4.4 Primi i garancisë

Sipas Marrëveshjes, Huadhënësi i faturon Huamarrësit një kompensim për prim të garancisë së OeKB-së në mënyrën e mëposhtme:

i) Primi i garancisë së OeKB-së dhe tarifa e administrimit e OeKB-së, e pagueshme në fillim.

Huamarrësi, brenda 30 ditëve kalendarike pas datës së mbylljes (por jo më vonë se 5 ditë pune përpara disbursimit të parë të shumës së kredisë) do t'i paguajë Huadhënësit një pjesë fillestare të kompensimit për primin e garancisë të OeKB-së dhe tarifën e administrimit të përcaktuar në aneksin 3 në shumat e përcaktuara në aneksin 3.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh

Duke filluar nga data e pagesës së interesit, që është pas datës së mbylljes, Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit kompensimin për primin e garancisë së OeKB-së, të pagueshëm si marzh, të përcaktuar në aneksin 3. Marzhi i primit të garancisë së OeKB-së është i kërkueshëm dhe i pagueshëm çdo tre muaj në datat e pagesës së interesit.

Grafiku i pagesës së shumave që do të kryhen sipas seksioni 4.4, do të përcaktohet në garancinë përfundimtare të lëshuar nga OeKB-së. Huadhënësi informon përkatësisht Huamarrësin për lëshimin e garancisë dhe grafikun e pagesës, dhe ky njoftim bëhet pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Nëse gjatë afatit të Marrëveshjes së kredisë për eksport, primet e garancisë së OeKB-së rriten, sepse: i) vlerësimi i riskut komercial i kryer nga OeKB-ja në lidhje me lëshimin e garancisë së OeKB-së ka ndryshuar; ose ii) ndryshimet materiale në afatet kontraktuale të Marrëveshjes së kredisë së eksportit janë miratuar, Huamarrësi do të rimbursojë Huadhënësin për këtë rritje, sipas kërkesës.

5. SHLYERJA

5.1 Shlyerja e detyrueshme

Huaja e papaguar në fund të periudhës së disponueshmërisë do të shlyhet nga Huamarrësi në një numër të barabartë këstesh gjashtëmujore shlyerjeje në datat e shlyerjes së detyrueshme, të përcaktuara në aneksin 3. Huadhënësi, brenda 15 ditëve kalendarike pas datës së pranimit të përkohshëm, do të njoftojë Huamarrësin për listën e datave të shlyerjes së detyrueshme dhe shumat e kërkueshme në secilën prej këtyre datave.

5.2. Parapagimi opsional

Huamarrësi mund të parapaguajë huan plotësisht ose pjesërisht (nëse pjesërisht, në shumën e përcaktuar në aneksin 3 ose shumëfishat integralë të saj), pas dhënies së një njoftimi me shkrim të paktën tridhjetë (30) ditë kalendarike para (ky njoftim do të jetë i parevokueshëm) datës së propozuar të parapagimit për Huadhënësin, në bazë të aprovimit të OeKB-së dhe pagesave të çdo kostoje ekuivalente me humbjen e llogaritur të shkaktuara nga Huadhënësi. Nëse bëhet gjatë

periudhës së disponueshmërisë, çdo parapagim i tillë do të reduktojë shumën e kredisë me një shumë të barabartë me këtë parapagim. Çdo referencë ndaj shumës së kredisë në këtë Marrëveshje më pas konsiderohet të jetë referencë ndaj shumës së caktuar në aneksin 3, të reduktuar. Nëse bëhet pas mbarimit të periudhës së disponueshmërisë, çdo parapagim i tillë do të aplikohet për të reduktuar me shuma të barabarta kështet e shlyerjes së kërkueshme në një kohë të mëvonshme.

6. PAGESAT

6.1 Njoftimi i pagesës

Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike para çdo date të pagesës së interesit ose sipas rastit, datës së shlyerjes së detyrueshme, Huadhënësi do të njoftojë Huamarrësin në lidhje me ato shuma që duhet të paguhen nga Huamarrësi për Huadhënësin, në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje në lidhje me principalin, interesin dhe tarifën e angazhimit, me kusht që pamundësia për dhënien e këtij njoftimi të mos lehtësojë Huamarrësin nga detyrimi i tij për të kryer pagesa të këtyre shumave të lartpërmendura, kur bëhen të kërkueshme.

Njoftimi përcakton, gjithashtu, për secilën pagesë që do të bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, shumën e saktë dhe qëllimin e pagesës (caktimi për shumat e kërkueshme dhe të pagueshme të njoftuara nga Huadhënësi) dhe Huamarrësi kryen pagesën në mënyrën e sugjeruar dhe konfirmon me shkrim aplikimin e fondeve. Huamarrësi informon Huadhënësin me shkrim për qëllimin e pagesës (caktimi i fondeve) për çdo shumë të paguar nga Huadhënësi. Nëse nuk është marrë ky informacion, zbatohet paragrafi 6.6.

Nëse ndonjë lloj shume debitohet dhe/ose kreditohet në llogarinë e huas dhe/ose në ndonjë llogari tjetër që mund të hapet në lidhje me këtë Marrëveshje në çdo kohë brenda pesëmbëdhjetë ditëve kalendarike para çdo date të pagesës së interesit, interesi ose çdo shumë tjetër e kërkueshme në lidhje me këtë datë të pagesës së interesit, do të barten dhe do të bëhen të kërkueshme dhe të pagueshme kundrejt Huadhënësin në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit (në rast të shumave të kredituara), do të rillogariten në datën e ardhshme pasuese të pagesës së interesit.

6.2 Mënyra e pagesës

Në çdo datë të pagesës së interesit, data e shlyerjes së detyrueshme ose në çdo datë tjetër për pagesën e çdo shume të kërkueshme dhe të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, sipas rastit, Huamarrësi do të kryejë pagesën e shumave dhe monedhës të kërkueshme në këtë datë nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje në Vjenë, me vlerë në datën e kërkueshme përkatëse.

Të gjitha pagesat e shumave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje nga Huamarrësi për Huadhënësin do të bëhen në Vjenë në euro, lirisht të konvertueshme dhe të transferueshme.

6.3 Heqja dorë nga kompensimi ose kundërpadia

Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë kompensimi ose kundërpadie që mund të ketë në lidhje me çdo shumë të detyrueshme kundrejt Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe bie dakord që nuk do të mbajë pagesë, për çfarëdolloj arsyeje, të ndonjë shume të kërkueshme për t'u paguar. Në veçanti, Huamarrësi nuk do të mbajë pagesa të shumave të detyrueshme për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje mbi bazën e një padie, të drejtë padie, të drejtë të ligjshme ose kërkesë kundër eksportuesit të projektit ose furnizuesve të tjerë në lidhje me projektin.

6.4 Pagesat pa mbajtje taksash dhe tarifat e tjera

Të gjitha pagesat që duhet të bëhen nga Huamarrësi sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen pa kompensim ose kundërpadi dhe do të jenë të lira dhe pa zbritje për ose në llogari të çdo takse, tatimi, shume të zbritur ose të mbajtur ose tarifa të tjera të tashme ose të ardhshme të çdo lloj natyre të Republikës së Shqipërisë, nëse Huamarrësit nuk i kërkohet me ligj ta bëjë këtë zbritje. Nëse kërkohet me ligj, shuma e kërkueshme nga Huamarrësi në lidhje me këtë pagesë do të rritet në masën e nevojshme për të garantuar që pas kësaj zbritjeje të taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera, Huadhënësi të marrë në datën e kërkuar për këtë pagesë një shumë

neto të barabartë me shumën që do të kishte marrë nëse kjo zbritje e taksave, tatimeve, shumave të zbritura, të mbajtura ose tarifave të tjera nuk do të ishte kërkuar. Huamarrësi do t'i japë menjëherë Huadhënësit fatura, vërtetime ose dëshmi të tjera, që provojnë shumat (nëse ka) e paguara ose të pagueshme në lidhje me çdo shumë të lartpërmendur të zbritur ose të mbajtur.

6.5. Kostot e rritura

Nëse rezultati:

- i një ndryshimi ose prezantimit të një ligji, rregulloreje ose kërkese rregullatore ose ndryshimi në interpretimin ose zbatimin e tyre; ose

- i respektimit nga Huadhënësi të çdo udhëzimi, kërkese detyrimi (që ka fuqinë e ligjit apo jo) të ndonjë banke qendrore, autoriteti financiar, rregullator ose autoriteti tjetër (duke përfshirë, në çdo rast pa kufizim, ato që lidhen me mjaftueshmërinë e kapitalit, likuiditetin, aktivët rezervë dhe depozitat e veçanta) është:

a) të rrisë koston ose të vendosë kosto shtesë për Huadhënësin për vënien ose ruajtjen në dispozicion të angazhimit të tij, ose ruajtjen ose financimin e huas; dhe/ose

b) të reduktojë shumën e pagueshme ose fitimin real për Huadhënësin sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

c) të reduktojë normën e fitimit të Huadhënësit mbi kapitalin e tij të përgjithshëm për shkak të një ndryshimi në mënyrën në të cilën kërkohet për të alokuar burimet e kapitalit për detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe/ose

d) t'i kërkojë Huadhënësit të kryejë një pagesë ose të heqë dorë nga një fitim mbi ose të llogaritur, ndaj çdo shume të marrë ose që duhet të merret nga ai sipas kësaj Marrëveshjeje,

atëherë Huamarrësi do t'i paguajë Huadhënësit, me kërkesë, çdo kosto të tillë uljeje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim.

Çdo vërtetim i Huadhënësit në lidhje me këtë kosto, ulje, pagesë ose heqje dorë nga një fitim, në mungesë të një gabimi të dukshëm, do të jetë provë përfundimtare dhe detyruese për Huamarrësin.

Për qëllim të kësaj klauzole, Huadhënësi mund të alokojë në mirëbesim ose të shpërndajë kostot dhe/ose humbjet mes aktivëve dhe pasivëve të tij (ose ndonjë kategorie të tyre) mbi bazën që çmon të nevojshme.

6.6 Caktimi i pagesave

Të gjitha pagesat e marra nga Huadhënësi prej Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje (nëse Huadhënësi nuk ndryshon urdhrin e zbatimit) duhet të zbatohen nga Huadhënësi kundrejt pagesës së shumave të kërkueshme, sipas kësaj Marrëveshjeje në rendin e mëposhtëm dhe Huamarrësi bie dakord për zbatimin e këtyre pagesave me këtë rend (dhe për çdo ndryshim të tyre nga Huadhënësi):

a) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.2 (tarifa dhe shpenzimet e menaxhimit);

b) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.3 (primi i garancisë së OeKB-së)

c) shumat e kërkueshme sipas seksionit 4.1 (tarifa e angazhimit);

d) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.3 (kamatëvonesa)

e) shumat e prapambetura sipas seksionit 3.1 (interesi);

f) shumat e prapambetura sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);

g) shumat e kërkueshme sipas seksionit 3.1 (interesi);

h) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.1 (shlyerja e detyrueshme);

i) shumat e kërkueshme sipas seksionit 5.2 (parapagimi opsional).

Huadhënësi do të informojë Huamarrësin rreth aplikimit të fondeve. Shumat e prapambetura shlyhen para shumave të kërkueshme. Çdo udhëzim për të kundërtën, i dhënë nga Huamarrësi, nuk merret parasysh.

Huamarrësi pranon që sipas garancisë së OeKB-së të ketë rezervuar ndaj Huadhënësit të drejtën për të ndryshuar caktimin e pagesave të përcaktuara më lart. Në këtë rast Huadhënësi do të informojë menjëherë Huamarrësin me shkrim dhe Huamarrësi do të pranojë caktimin e OeKB-së dhe do të marrë përsipër të shlyejë huan dhe çdo shumë tjetër të papaguar sipas kësaj Marrëveshjeje të njoftuar në atë kohë (duke përfshirë një llogaritje të hollësishme) nga Huadhënësi për Huamarrësin.

7. KUSHTET PARAPRAKE

Kjo shumë kredie do të vihet në dispozicion për Huamarrësin në datën (data e mbylljes) kur Huamarrësi njoftohet nga Huadhënësi se kushtet e mëposhtme janë përmbushur në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Huadhënësin:

i) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) një kopje të Marrëveshjes së blerjes të pranueshme në formë dhe të pranueshme për Huadhënësin, së bashku me një vërtetim nga eksportuesi i projektit në një datë jo më shumë se katërmbëdhjetë ditë kalendarike përpara datës së mbylljes, me qëllim që Marrëveshja e blerjes në formën e paraqitur për Huadhënësin të jetë në fuqi dhe efekt të plotë (aneksi 6);

b) një opinion të Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë të pranueshëm për Huadhënësin me atë përmbajtje që mund të kërkojë Huadhënësi (sipas aneksit 5), së bashku me kopje të vërtetuara të çdo miratimi ose autorizimi të përmendur në atë opinion;

c) një kopje të vendimit të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që miraton në parim këtë Marrëveshje;

d) një prokurë të lëshuar nga Kryeministri i Republikës së Shqipërisë që autorizon një person ose persona të caktuar për të nënshkruar këtë Marrëveshje dhe të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera të cilat duhet të nënshkruhen dhe/ose dërgohen në lidhje me këtë Marrëveshje;

e) një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje, të nënshkruar sipas rregullave nga një person ose persona të autorizuar me prokurën e përmendur në paragrafin (d) më sipër;

f) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të Huamarrësit;

g) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimet e tjera që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të blerësit të projektit;

h) modele firmash të vërtetuara të personit ose personave të autorizuar për të nënshkruar të gjitha dokumentet dhe njoftimin që duhet t'i jepen Huadhënësit sipas kësaj Marrëveshjeje në emër të "Kontraktorit" dhe "Palës së tretë", siç përcaktohet në nënklauzolën 1.1.2.7 të Marrëveshjes së blerjes;

i) emërim të një personi kontakti për Huamarrësin në Republikën e Austrisë për Marrëveshjen (aneksi 7);

j) çdo dokument, provë ose autorizim tjetër që Huadhënësi mund të kërkojë, me qëllim që ta bëjë këtë Marrëveshje dhe transaksionet e parashikuara nën të, një marrëveshje ligjore, të vlefshme, detyruese dhe të zbatueshme.

ii) Huadhënësi do të ketë marrë:

a) garancinë e lëshuar nga OeKB për dhe në emër të Republikës së Austrisë, në pajtim me ligjin e promovimit të eksportit të vitit 1981, të ndryshuar, termat dhe kushtet e të cilit mund të përmbushen nga Huadhënësi;

b) një marrëveshje rifinancimi me OeKB-në për huan;

c) një marrëveshje plotësuese me eksportuesin e projektit dhe miratimin e kësaj Marrëveshjeje nga autoritetet e Huadhënësit.

iii) Çdo kusht plotësues (nëse ka) të kërkuar në garancinë e Republikës së Austrisë të lëshuar nga OeKB.

Me përmbushjen e të gjitha kushteve të lartpërmendura, Huadhënësi do të njoftojë menjëherë Huamarrësin për këtë qëllim. Nëse këto kushte nuk do të jenë përmbushur brenda periudhës së mbylljes të përcaktuar në aneksin 3 të kësaj Marrëveshjeje, pa cenuar detyrimin e Huamarrësit sipas seksionit 4.2, kjo Marrëveshje nuk do të jetë më detyruese për palët.

Secili prej këtyre dokumenteve dhe njoftimeve do të jetë në gjuhën angleze ose gjermane. Nëse nuk është në gjuhën angleze ose gjermane, një përkthim i vërtetuar në gjuhën angleze i bashkëlidhet dokumentit të lartpërmendur.

8. RASTET E MOSPLOTËSIMIT TË DETYRIMEVE

8.1 Rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Secili prej rasteve të mëposhtme përbën një rast të mosplotësimit të detyrimeve:

a) ka pamundësi pagese nga Huamarrësi, për më shumë se katërmbëdhjetë (14) ditë kalendarike, të ndonjë principali, interesi ose shume tjetër të kërkueshme në lidhje me huan; ose

b) Huamarrësi është i paaftë për të përmbushur ose respektuar siç duhet kushte ose sipërmarrje në përmbajtje të kësaj Marrëveshjeje, të ndryshme nga pagesa e principalit, interesit ose shuma të tjera për një periudhë prej tridhjetë (30) ditësh kalendarike nga data më e hershme në të cilën Huamarrësi vihet në dijeni të pamundësisë së pagesës dhe data në të cilën njoftimi me shkrim për këtë pamundësi pagese që kërkon nga Huamarrësi përmbushjen e detyrimit, i është dhënë më parë Huamarrësit nga Huadhënësi; ose

c) çdo garanci ose sipërmarrje e bërë nga Huamarrësi në lidhje me këtë Marrëveshje do të rezultojë të ketë qenë e pasaktë në aspekte materiale në kohën kur është bërë; ose

d) Huamarrësi do të jetë në mosplotësim të pagesës ose përmbushjes së një detyrimi në lidhje me paratë e marra hua të ndryshme nga huaja (duke përfshirë në çdo rast një detyrim sipas një garancie); ose

e) çdo autorizim, pëlqim, regjistrim ose aprovim (zyrtar apo tjetër) të kërkuara për vlefshmërinë, zbatueshmërinë ose ligjshmërinë e kësaj Marrëveshjeje ose huaje ose ekzekutimi i të cilave është tërhequr ose për ndonjë arsye pushon së qenuri në fuqi dhe efekt të plotë; ose

f) Republika e Shqipërisë shpall një moratorium të përgjithshëm për detyrimet e pagesës ndaj kreditorëve të saj; ose

g) çdo ngjarje që ka, në diskrecionin e arsyeshëm të Huadhënësit, ndikim negativ material në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose

h) garancia e Republikës së Austrisë e lëshuar nga OeKB-ja ose ndonjë prej dispozitave të saj është anuluar, ka përfunduar ose ka pushuar së qenuri në fuqi dhe efekt, ose ka pushuar së dhënuri garancinë e synuar ose bëhet e paligjshme ose shpallet e pavlefshme për arsye, raste ose rrethana që mund t'i atribuohen sferës së Huamarrësit.

8.2 Masat për rastet e mosplotësimit të detyrimeve

Nëse ka ndodhur një rast i mosplotësimit të detyrimeve dhe në çdo kohë më pas ndonjë ose të gjitha prej masave të mëposhtme që mund të merren nga Huadhënësi do të jenë të vazhdueshme:

a) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë principalin dhe interesin e shtuar në lidhje me huan dhe të gjitha shumat e tjera të pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje, si menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pas të cilit do të bëhen menjëherë të kërkueshëm dhe të pagueshëm, pa deklarim, kërkesë, kundërshtim ose njoftim tjetër të çdo lloji;

b) Huadhënësi, me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar Huamarrësit, mund të shpallë të përfunduar shumën e kredisë, pas të cilës detyrimi i Huadhënësit për të realizuar dhe vazhduar huan sipas kësaj Marrëveshjeje do të përfundojë menjëherë; dhe

c) çdo masë tjetër që Huadhënësi mund të vendosë të marrë, sipas diskrecionit të tij absolut.

Huamarrësi bie dakord t'i paguajë Huadhënësit, sipas kërkesës, të gjitha humbjet, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet që Huadhënësi mund të ketë si pasojë e mosplotësimit të detyrimeve (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ndonjë interes të paguar nga Huadhënësi për huadhënësit e fondeve të marra hua nga ai për të ruajtur shuma të vonuara). Një vërtetim nga një nëpunës i autorizuar rregullisht i Huadhënësit, që përcakton shumën e këtyre humbjeve, shpenzimet e arsyeshme dhe detyrimet dhe bazën e llogaritjes së tyre, kur i paraqiten Huamarrësit (përveç ndonjë gabimi të dukshëm) do të jenë prova përfundimtare të sasisë së këtyre humbjeve, shpenzimeve dhe detyrimeve, me kusht që ky vërtetim të mbështetet nga dokumente që japin të dhëna për këto humbje, shpenzime dhe detyrime dhe këto vërtetime do të mbështeten nga dokumentet e caktuara.

Huamarrësi, sapo të vihet në dijeni për këtë, do t'i japë njoftim me shkrim Huadhënësit për:

a) çdo rast të mosplotësimit të detyrimeve; ose

b) çdo kusht, ngjarje ose veprim që, me dhënien e njoftimit ose kalimin e kohës ose të dyjave, ose përmbushjen e ndonjë kushti mund të çonte ose përbënte një rast të mosplotësimit të detyrimeve.

9. GARANCITË DHE SIPËRMARRJET

9.1 Garancitë

Me qëllim inkurajimin e Huadhënësit për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të parapaguar dhe mbajtur huan e parashikuar në këtë Marrëveshje, Huamarrësi jep garancitë e mëposhtme në datën e pranimit:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë Republikën e Shqipërisë para detyrimit ligjor. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Republika e Shqipërisë mund të paditet në emër të saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) Huamarrësi nuk është në mosplotësim të ndonjë prej detyrimeve të tij të pagesës dhe nuk ka ndodhur ose nuk po vazhdon asnjë rast i mosplotësimit të detyrimeve; ose

c) Huamarrësi ka autoritetin për të lidhur këtë Marrëveshje dhe për të marrë hua sipas saj dhe për të ekzekutuar, shpallur dhe realizuar këtë Marrëveshje dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të lejuar kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje dhe për të lejuar ekzekutimin, shpalljen dhe realizimin e kësaj Marrëveshjeje që përbën detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues të Huamarrësit, të zbatueshëm në pajtim me kushtet e tij; ose

d) Ekzekutimi, shpallja dhe realizimi i kësaj Marrëveshjeje nuk do të shkelë dispozitat e ndonjë ligji ose rregulloreje të zbatueshme për Huamarrësin ose ndonjë marrëveshjeje, kontrate ose sipërmarrjeje tjetër në të cilën Huamarrësi është palë ose që është detyruese për të ose asetet e tij; ose

e) Të gjitha autorizimet, miratimet, regjistrimet ose aprovimet (zyrtare ose të tjera) të nevojshme në lidhje me ekzekutimin, shpalljen, realizimin, vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje janë marrë ose realizuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë.

Garancitë e paraqitura më sipër do të vazhdojnë edhe pas ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje dhe do të konsiderohen të përsëritura në çdo datë të Huamarrjes dhe në çdo datë të pagesës së interesit.

9.2 Sipërmarrjet

Huamarrësi zotohet dhe merr përsipër me dhe për Huadhënësin, si më poshtë:

a) Të dhënat

Huamarrësi do të marrë masa që:

1) i) blerësi i projektit të mbajë të dhëna të mjaftueshme për të identifikuar mallrat dhe shërbimet e financuara nga huaja; ii) blerësi i projektit informon në lidhje me përdorimin e tyre në projekt; dhe iii) blerësi i projektit regjistron progresin e projektit, duke përfshirë koston e tij;

2) përfaqësuesit e Huadhënësit të lejohen të inspektojnë projektin, sipërmarrjen e blerësit të projektit, mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së blerjes dhe çdo të dhënë dhe dokument tjetër;

3) për t'u informuar ose për t'i dhënë Huadhënësit të gjithë informacionin që Huadhënësi kërkon në lidhje me shpenzimet e huas, projektin dhe mallrat dhe shërbimet e dhëna sipas Marrëveshjes së blerjes.

b) *Pari passu* dhe pengu negativ

Detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje klasifikohen të paktën *pari passu* dhe njëlloj me të gjitha detyrimet e tjera të papaguara, të pasiguruara dhe të pavarura të Huamarrësit. Nga data e pranimit dhe për sa kohë që një pjesë e huas do të mbetet e papaguar, Huamarrësi nuk do të krijojë ose bjerë dakord për të krijuar ndonjë hipotekë, detyrim, peng, barrë ose interes tjetër garancie mbi të gjithë ose një pjesë të aseteve të tij për të siguruar detyrime ose garanci të ndonjë detyrimi, nëse huaja nuk sigurohet në mënyrë të barabartë dhe përpjesëtimore, të pranueshme për Huadhënësin.

c) Amendimi i Marrëveshjes së blerjes

Huamarrësi nuk do të bëjë, lejojë ose miratojë ndonjë amendim, ndryshim, modifikim ose përfundim të Marrëveshjes së blerjes, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

10. LIGJI RREGULLUES DHE MOSMARRËVESHJET

a) Kjo Marrëveshje rregullohet nga ligji i Republikës së Austrisë.

b) Të gjitha mosmarrëveshjet që lindin mbi këtë Marrëveshje, duke përfshirë lidhjen e saj, vlefshmërinë dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve sipas kësaj Marrëveshjeje, zgjidhen përfundimisht nga tre arbitra, sipas rregullave të pajtimit dhe arbitrazhit, në atë kohë në fuqi, të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë në Paris.

c) Vendi i arbitrazhit është Parisi. Gjuha që do të përdoret në procedimet e arbitrazhit do të jetë anglishtja.

d) Vendimi i arbitrazhit përcakton përgjegjësinë e palëve për kostot e shkaktuara nga palët.

e) Arbitrat do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të kryer procedimet dhe për të përgatitur vendimin e tyre, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshëm sipas ligjit.

f) Gjykimi për vendimin mund të zhvillohet në çdo gjykatë që ka juridiksion ose në atë gjykatë mund të bëhet kërkesë për një pranim gjyqësor të vendimit dhe urdhër ekzekutimi, sipas rastit.

g) Nëse Huadhënësi merr masa ligjore (duke përfshirë padinë, arbitrazhin, sekuestrimin, ekzekutimin ose masa të tjera zbatuese ose mbrojtëse) kundër Huamarrësit në lidhje me ndonjë çështje që lind sipas kësaj Marrëveshjeje, Huamarrësi heq dorë nga çdo e drejtë imuniteti që mund të ketë Huamarrësi.

Përjashtimisht, Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti mbi ekzekutimin e një vendimi arbitrazhi, në lidhje me:

i) "ambientet e tashme ose të ardhshme të misionit" siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike, të nënshkruar në 1961, "ambientet e tashme ose të ardhshme konsullore", siç përcaktohet në Konventën e Vjenës për marrëdhëniet konsullore, të nënshkruar në 1963 ose të përdorur ndryshe nga një diplomat ose mision diplomatik i Shqipërisë;

ii) çdo pasuri të paluajtshme që përmendet në nenin 3, paragrafët 1-3 të ligjit shqiptar nr.8743 të datës 22.2.2001 "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore";

iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë të kërkueshme në momentin e ekzekutimit, që është caktuar për përmbushjen e detyrimeve që Republika e Shqipërisë ka sipas të drejtës publike ndërkombëtare.

h) Huamarrësi cakton Ambasadën e Republikës së Shqipërisë si personin e saj të kontaktit në Vjenë (aneksi 7).

11. TË PËRGJITHSHME

11.1 Njoftimet

Të gjitha njoftimet, shkresat, kërkesat dhe komunikimet e tjera do të jenë të vlefshme në rast njoftimi me shkrim me letër rekomande kur merret, ose në rast të njoftimit me faks, kur merret nga pala për të cilën ky njoftim, kjo shkresë, kërkesë ose komunikim tjetër kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kësaj Marrëveshjeje, drejtuar Huamarrësit ose Huadhënësit përkatësisht në adresat e tyre të përcaktuara në aneksin 1 ose në një adresë tjetër që njëri prej tyre mund të caktojë më pas me shkrim për tjetrin, në pajtim me këtë seksion 11.1.

11.2 Titujt përshkrues

Titujt në këtë Marrëveshje janë vetëm për lehtësi reference dhe nuk përcaktojnë ose kufizojnë dispozitat e saj.

11.3 Heqjet dorë, mjetet ligjore kumulative

Asnjë pamundësi ose vonesë nga ana e Huadhënësit në ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje dhe asnjë kurs transaksioni ndërmjet Huamarrësit dhe Huadhënësit nuk operon si heqje dorë nga to; një ushtrim i vetëm ose i pjesshëm i një të drejte, kompetence ose privilegji sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të përjashtojë një ushtrim tjetër ose të mëtejshëm të tyre ose ushtrimin e një të drejte, kompetence ose privilegji tjetër. Të drejtat dhe mjetet ligjore në këtë marrëveshje të parashikuara shprehimisht janë kumulative dhe nuk janë ekskluzive për ndonjë të drejtë ose mjet ligjor që Huadhënësi do të kishte ndryshe. Asnjë njoftim ose kërkesë ndaj Huamarrësit në ndonjë rast nuk autorizon Huamarrësin për njoftim ose kërkesë tjetër ose të mëtejshme në lidhje me të njëjtat rrethana ose nuk përbën heqje dorë nga të drejtat e Huadhënësit për ndonjë veprim tjetër ose të mëtejshëm në lidhje me këto rrethana, pa njoftim ose kërkesë.

11.4 Pavlefshmëria e pjesshme

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje çmohet nga një gjykatë ose organ tjetër kompetent gjyqësor, si e pazbatueshme, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave të tjera të saj nuk do të cenohet ose dëmtohet dhe palët do të bëjnë të gjitha përpjekjet për të rishikuar dispozitën e pavlefshme, në mënyrë që ta bëjnë të zbatueshme në pajtim me qëllimin e shprehur në të.

11.5 Transferimi

Huamarrësi nuk mund të caktojë ose transferojë të gjitha ose një pjesë të të drejtave dhe detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Huadhënësit.

Huadhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje: i) pa pëlqimin e Huamarrësit, nëse drejtëmarrësi është OeKB ose (në rast vetëm të mosplotësimit të detyrimeve) çdo bankë ose institucion tjetër financiar; dhe ii) me pëlqimin paraprak me shkrim të Huamarrësit, që nuk do të ndalohet në mënyrë të paarsyeshme për ndonjë drejtëmarrës tjetër.

11.6 Konfidencialiteti

Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi bie dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të paraqitur në një mënyrë që është e zakonshme nga bankat, të gjithë informacionin që ai merr në lidhje me këtë marrëveshje ose marrëdhënien e tij të punës me Huamarrësin-veçanërisht në interes të një mbrojtjeje të arsyeshme të kreditorëve-për bankat, institucionet e përbashkëta të bankave ose organizatat e përzgjedhura për mbrojtjen e kreditorëve.

Me anë të kësaj Marrëveshjeje Huamarrësi bie më tej dakord që Huadhënësi të ketë të drejtën për të dhënë informacion që rezulton nga kjo Marrëveshje ose nga marrëdhënia e punës së Huadhënësit me Huamarrësin për personat ose shoqëritë e mëposhtme:

a) çdo anëtar të grupit të shoqërive të Huadhënësit;

b) një drejtëmarrës i mundshëm ose për çdo person ose shoqëri tjetër që mund të propozojë hyrjen në marrëdhënie kontraktuale me Huadhënësin në lidhje me këtë Marrëveshje;

c) OeKB dhe Republikën e Austrisë; dhe

d) çdo person, autoritet ose subjekt tjetër për të cilin Huadhënësit i kërkohet të japë këtë informacion sipas ndonjë ligji ose urdhri gjykate ose organi tjetër gjyqësor ose organi rregullator, udhëzimet e të cilit duhet të respektohen nga Huadhënësi.

11.7 Amendimet e Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje nuk mund të ndryshohet ose amendohet përveçse me instrumente me shkrim.

12. Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi me nënshkrimin nga palët dhe miratimin nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe botimin në Fletoren Zyrtare Shqiptare**.**

Në dëshmi të kësaj, palët kanë ekzekutuar këtë Marrëveshje në datën e shkruar më parë më sipër, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe versioni në gjuhën angleze do të jetë detyrues dhe do të ketë përparësi mbi përkthimet.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrësi
(i përfaqësuar nga Ministria e Financave)

UniCredit Bank Austria AG si Huadhënësi

ANEKSI I

PALËT

HUAMARRËSI

Emri:	Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (i përfaqësuar nga Ministria e Financave)
Adresa:	Ministria e Financave Bul.: “Dëshmorët e Kombit”, nr.1 Tirana, Albania
Telefon:	(355 4) 222 84 05
Faks:	(355 4) 222 84 94

HUADHËNËSI

Emri:	UniCredit Bank Austria AG
Adresa:	Schottengasee 6-8, A-1010 Vienna
Telefon:	+43 (0)5 05 05-50326
Faks:	+43 (0)5 05 05-56934
Departamenti përgjegjës:	8243 Export Finance (Financat e eksportit)
Në vëmendje të:	Z. Gerd E. Rose

ANEKSI 2

1. Projekti

Projekti i furnizimit me ujë të Bilishtit

2. Marrëveshja e blerjes

Kontrata kryesore e nënshkruar në Bilisht, më 26 prill 2011, ndërmjet Duktus Tiroler Rohrensysteme GmbH, Hall in Tirol (në vijim i quajtur "Kontraktori") dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit të Republikës së Shqipërisë, Tiranë (këtu i quajtur "Punëdhënësi") në shumën prej 7,505,420.80 euro (shtatë milionë e pesëqind e pesë mijë e katërqind e njëzet dhe 80/100) në lidhje me projektin.

ANEKSI 3

1. Llogaria e kredisë (paragrafi 2.2)

Një shumë që nuk kalon 7,505,420.80 euro (shtatë milionë e pesëqind e pesë mijë e katërqind e njëzet dhe 80/100).

2. Periudha e disponueshmërisë (paragrafi 2.2)

Nga data e mbylljes (siç përcaktohet në paragrafin 7) deri në ditën që bie 24 muaj pas datës së mbylljes.

3. Interesi (paragrafi 3.1)

0 për qind në vit.

4. Kamatëvonesa (paragrafi 3.3)

3 muaj euribor plus një marzh prej 2% në vit.

5. Tarifa e angazhimit (paragrafi 4.1)

0.5 % në vit (zero pikë pesë për qind në vit).

6. Tarifa e menaxhimit (paragrafi 4.2)

0.5 (zero pikë pesë për qind), e pandryshuar ndaj shumës së kredisë.

7. Primi i garancisë (paragrafi 4.3)

i) Primi i garancisë së OeKB-së paraprakisht i pagueshëm:

53,553.39 euro (vetëm një e dhënë).

Shuma përfundimtare do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare. Nëse shuma përfundimtare ndryshon nga shuma e treguar, Huamarrësi do të paguajë diferencën (nëse ka) brenda 30 ditëve kalendarike pasi të jetë njoftuar për të nga Huadhënësi.

ii) Primi i garancisë së OeKB-së i pagueshëm si marzh:

1.039 për qind në vit

Sipas OeKB-së norma e mësipërme mbështetet nga një grand shtesë që arrin rreth 365,664.11 euro nga Ministria Federale e Financave e Austrisë. Norma dhe grandi përfundimtar, nëse ka, do të përcaktohet nga OeKB-ja pas lëshimit të garancisë fillestare.

8. Tarifa e trajtimit e OeKB-së

1,440 euro në lidhje me sigurimin e kredisë së eksportit.

9. Datat e detyrueshme të shlyerjes (paragrafi 5.1)

Shlyerja do të realizohet deri në 17 këste të barabarta gjashtëmujore të njëpasnjëshme, ku i pari duhet të paguhet 48 muaj pas datës së përkohshme të pranimit, në çdo rast jo më vonë se 57 muaj pas datës së mbylljes.

10. Shuma opsionale e parapagimit (paragrafi 5.2)

500,000 euro.

11. Periudha e mbylljes (paragrafi 7)

Periudha që fillon në datën e pranimit deri maksimumi 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike pas datës së pranimit.

ANEKSI 4
PROCEDURAT E PAGESËS

Huamarrësi autorizon Huadhënësin në mënyrë të parevokueshme që të paguajë eksportuesin e projektit deri në maksimumin e përgjithshëm të shumës së kredisë të përmendur në aneksin 3 kundrejt paraqitjes së dokumenteve të mëposhtme pranë Huadhënësit.

Paradhënia

20 % (njëzet për qind) e shumës së Marrëveshjes së blerjes e cila është 1,501,084.16 euro (me fjalë: një milion e pesëqind e një mijë e tetëdhjetë e katër 16/100) janë të pagueshme si paradhënie menjëherë pas paraqitjes së:

- faturës nr.0 (paradhënie fillestare) në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje;
- kopje të garancisë së paradhënies të lëshuar nga një bankë austriake në shumën prej 20 % të Marrëveshjes së blerjes.

Pagesa për shërbimet dhe punimet

70% (shtatëdhjetë për qind) e shumës së Marrëveshjes së blerjes e cila është 5,253,794.56 euro (me fjalë: pesë milionë e dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë e katër 56/100) janë të pagueshme me paraqitjen e dokumenteve të mëposhtme:

- faturat (nr.1 deri dhe përfshirë nr.81) që përcaktohen në shtojcën e Marrëveshjes së blerjes, secila në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Shënim.

Fatura nr.71 (që tregon "16. Asistenca teknike") do të përbëhet nga 21 fatura gjithsej të quajtura fatura 71.1, deri dhe duke përfshirë faturën 71.21. Totali i të gjitha këtyre faturave 71 nuk do të tejkalojë shumën prej 532,700 euro (pra, 20 pagesa që arrijnë shumën prej 25,366.67 euro secila dhe një pagesë në shumën prej 25,366.60 euro).

Secila faturë (nr.1 deri dhe duke përfshirë nr.81) do të tregojë:

- përshkrimin (emrin) e paketës përkatëse;
- një datë;
- vlerën e përgjithshme të paketës përkatëse;
- shumën që do të paguhet për eksportuesin e projektit;
- nënshkrimin e përfaqësuesve të autorizuar të palëve.

Pagesa kundrejt certifikatave të pranimit

10 % (dhjetë për qind) e shumës së kontratës së blerjes, e cila është 750,542.08 euro (me fjalë: shtatëqind e pesëdhjetë mijë e pesëqind e dyzet e dy 8/100) janë të pagueshme kundrejt paraqitjes së:

- faturës nr.82 (dëftesë e marrjes në dorëzim të përkohshëm) në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje; dhe
- faturës nr.83 (dëftesë e marrjes përfundimtare në dorëzim) në 1 (një) kopje origjinale dhe 3 (tri) kopje.

Huadhënësit i jepet e drejta të bazohet në çdo dokument, të cilin e konsiderojnë si të vërtetë dhe të saktë dhe që është nënshkruar ose dërguar nga personi përkatës. Huadhënësi nuk mban përgjegjësi apo detyrime për formën, mjaftueshmërinë, saktësinë, vërtetësinë, falsifikimin apo fuqinë ligjore të secilit dokument/e ose për kushtet e përgjithshme dhe/ose të veçanta të parashikuara në dokument/e apo të mbivendosura mbi to; as merr përsipër detyrime ose përgjegjësi për

përshkrimin, sasinë, peshën, cilësinë, kushtet, paketimin, shpërndarjen, vlerën apo ekzistencën e mallrave ose shërbimeve të përfaqësuara nga secili dokument/e, ose për mirëbesimin apo veprimet dhe/ose mosveprimet, aftësinë paguese, performancën apo qëndrimin e dërguesve të mallrave, transportuesve, marrësve të ngarkesës apo siguruesve të mallrave ose të çdokujt personi tjetër.

Lejohen dërgesa dhe paraqitje të pjesshme të dokumenteve.

Huadhënësi do t'i japë Huamarrësit një njoftim me shkrim pas realizimit të një huamarrjeje për eksportuesin e projektit.

Pasi një Huamarrje të jetë realizuar për eksportuesin e projektit, Huadhënësi do t'i ridërgojë dokumentet përkatëse Huamarrësit, në…… , adresën ……. me anë të një shërbimi të veçantë korrier.

ANEKSI 5
OPINION LIGJOR

(Model)

Nga: Ministri i Drejtësisë i Republikës së Shqipërisë
Për: UniCredit Bank Austria AG

Datë: ……

Unë, ……, duke vepruar në cilësinë e Ministrit të Drejtësisë të Republikës së Shqipërisë, i referohem marrëveshjes së eksportit të kredisë për një hua të butë nr.230.409 për shumën prej 7,505,420.80 euro (Marrëveshja) datë: ……. 2011 dhe të lidhur ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si Huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) si huamarrësi (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi). Nuk shpreh asnjë opinion në lidhje me ligjet e një juridiksioni të ndryshëm nga ai i Republikës së Shqipërisë.

Kam shqyrtuar kopjen e nënshkruar dhe të ekzekutuar të Marrëveshjes dhe dokumente të tjera që i kam konsideruar të nevojshme dhe të përshtatshme, me qëllim që të mund të jap këtë opinion. Afatet e përcaktuara në Marrëveshje kanë të njëjtin kuptim, përveç kur Marrëveshja përcakton ndryshe.

Sa më sipër, jam i mendimit se:

a) Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë autorizohet të veprojë në emër të dhe për Republikën e Shqipërisë dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Republikës së Shqipërisë. Si pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të pakufizuara dhe të pakushtëzuara të Republikës së Shqipërisë. Ndaj Republikës së Shqipërisë mund të ngrihet padi në emrin e saj në lidhje me detyrimet e Huamarrësit sipas kësaj Marrëveshjeje.

b) Ministria e Financave autorizohet të veprojë në emër të Huamarrësit dhe të vendosë detyrim ligjor ndaj Huamarrësit. Si pasojë, të gjitha detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje janë detyrime të vlefshme, ligjërisht detyruese dhe të zbatueshme të Huamarrësit. Huamarrësi ka autoritet të ngrejë padi apo t'i ngrihet padi në emrin e tij.

c) Huamarrësi gëzon autoritetin për të lidhur/nënshkruar dhe realizuar Marrëveshjen. Huamarrësi ka marrë të gjitha masat e nevojshme (zyrtare dhe të tjera) për të autorizuar nënshkrimin e Marrëveshjes sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në të, si dhe ekzekutimin, shpalljen dhe realizimin e Marrëveshjes.

d) Marrëveshja është nënshkruar nga z. …… në cilësinë e tij si Ministër i Financave i Republikës së Shqipërisë.

e) Marrëveshja e nënshkruar nga Ministri i Financave në emër të Huamarrësit përbën detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin, të zbatueshme në gjykatat e Republikës së Shqipërisë në përputhje me afatet e saj.

f) Personi ose personat që nënshkruajnë Marrëveshjen, të cilët nënshkruajnë apo vërtetojnë çdo dokument tjetër në lidhje me Marrëveshjen, kanë fuqi dhe autoritet të plotë për të vepruar kështu në emër të Huamarrësit.

g) Ekzekutimi dhe realizimi i Marrëveshjes dhe transaksionet e parashikuara në lidhje me të nuk janë në kundërshtim me: i) ligjet, rregulloret ose urdhrat zyrtare apo gjyqësore; ii) traktatet, marrëveshjet ose dokumente apo instrumente të tjera, në të cilët Huamarrësi dhe/ose Republika e Shqipërisë janë palë ose që janë detyruese mbi të apo mbi asetet e saj përkatëse.

h) Të gjitha autorizimet, aprovimet (përfshirë, nëse është e nevojshme, aprovimet e shkëmbimeve të kontrollit), miratimet, lejet, përjashtimet, të dhënat, regjistrimet, noterizimet dhe kërkesat e tjera të autoriteteve dhe institucioneve qeveritare, gjyqësore dhe publike të nevojshme ose të rekomandueshme në lidhje me ekzekutimin, zbatimin, vlefshmërinë dhe realizimin e Marrëveshjes apo çdo pagese të realizuar sipas saj, janë lëshuar dhe janë në fuqi dhe efekt të plotë dhe Huamarrësi gëzon autoritetin e plotë për të kryer të gjitha pagesat sipas Marrëveshjes në euro.

i) Të gjitha shumat që do të paguhen nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes mund të realizohen të plota dhe pa zbritje për ose për sa i përket çdo tarife, takse, zbritjeje apo detyrimi nga Republika e Shqipërisë, çdo autoriteti tatimor apo nënndarjeje politike. Në rast të një ndalimi/zbritjeje për sa i përket pagesave të interesit sipas Marrëveshjes, detyrimi i Huamarrësit për të paguar shuma shtesë sipas paragrafit 6.4 mbetet i vlefshëm dhe i zbatueshëm.

j) Kjo Marrëveshje është miratuar nga Parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Shqiptare dhe nuk është e nevojshme apo e rekomandueshme që të sigurohet ligjshmëria, vlefshmëria, zbatueshmëria apo pranueshmëria si dëshmi të Marrëveshjes, në mënyrë që të arkivohet apo regjistrohet pranë një autoriteti tjetër qeveritar ose agjencie në Republikën e Shqipërisë.

k) Zgjedhja e ligjit të Republikës së Austrisë për të rregulluar Marrëveshjen është një zgjedhje e vlefshme e ligjit dhe do të njihet dhe zbatohet në çdo gjykatë në Republikën e Shqipërisë.

Huamarrësi i nënshtrohet ligjit civil në lidhje me detyrimet e tij sipas Marrëveshjes. Lidhja dhe realizimi i Marrëveshjes nga Huamarrësi përbën akte private dhe tregtare. Heqja dorë nga imuniteti në paragrafin 10. g) të Marrëveshjes është e vlefshme dhe detyruese për Huamarrësin.

l) Nuk është e nevojshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë: i) me qëllim që Huadhënësit t'i jepet mundësia për të zbatuar të drejtat e tij përkatëse sipas Marrëveshjes; ose ii) për shkak të ekzekutimit, shpalljes, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes, që Huadhënësi të licencohet, kualifikohet apo t'i jepet e drejta për të kryer veprimtari biznesi në Republikën e Shqipërisë.

Huadhënësi as është, as do të jetë rezident, banues, as nuk do të kryejë veprimtari biznesi apo t'i nënshtrohet tatimeve në Republikën e Shqipërisë për shkak vetëm të ekzekutimit, shpalljes, realizimit ose zbatimit të Marrëveshjes.

m) Dispozitat e paragrafit 10 të Marrëveshjes janë të ligjshme, të vlefshme dhe detyruese sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

Gjykatat e Republikës së Shqipërisë do të njohin çdo vendim dhe/ose vendim arbitrazhi në lidhje me Marrëveshjen si të vlefshëm dhe përfundimtar dhe do të zbatojnë këto vendime gjyqësore dhe/ose vendime arbitrazhi.

Një vendim i kuotuar në euro (euro) do të njihet dhe zbatohet në Republikën e Shqipërisë.

Për sa jam i informuar, nuk ekziston asnjë procedim gjyqësor, arbitrazhi apo administrativ aktual apo i mbetur pezull ose, që sipas informacionit tonë, do të kryhej ndaj Huamarrësit, që do të kishte rezultuar ose mund të rezultonte në një ndryshim të pafavorshëm material në gjendjen financiare apo korporative të Huamarrësit.

n) Marrëveshja dhe të gjitha dokumentet e tjera nuk përmbajnë ndonjë dispozitë e cila mbetet e pazbatueshme sipas ligjit të Republikës së Shqipërisë.

o) Detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes do të renditen në çdo kohë *pari passu* me të gjitha detyrimet e tjera të Huamarrësit, përveç detyrimeve të parashikuara si të detyrueshme me ligj.

Ky opinion ligjor jepet për përfitimin e vetëm të Huadhënësit dhe nuk mund t'i njoftohet një personi tjetër.

Me respekt

ANEKSI 6
KONFIRMIMI SE MARRËVESHJA E BLERJES MBETET NË FUQI DHE EFEKT TË PLOTË

{Huadhënësi}

Lënda: Marrëveshja e kredisë për eksport për një hua të butë nr.230.409 për një shumë prej 7,505,420.80 eurosh (Marrëveshja) e datës: ……. 2011 dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi).

Të nderuar zotërinj,

Me anë të kësaj shkrese ju konfirmojmë se Marrëveshja e blerjes [nr. …] e lidhur më [……] ndërmjet [……] dhe [……] ka hyrë në fuqi më [……].

Vjenë, ……
……
[Eksportuesi i projektit]

ANEKSI 7
PRANIMI I EMËRIMIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT

[Huadhënësi]

Lënda: Marrëveshja e kredisë për eksport për një hua të butë nr.230.409 për shumën prej 7,505,420.80 eurosh (Marrëveshja) e datës: ……. 2011 dhe ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë si huamarrës (përfaqësuar nga Ministri i Financave) (Huamarrësi) dhe UniCredit Bank Austria AG si huadhënës (Huadhënësi).

Të nderuar zotërinj,

Si Ambasador i Republikës së Shqipërisë në Vjenë, Republika e Austrisë, pranoj, në emrin tim dhe në emër të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë, caktimin si person të autorizuar të Huamarrësit për të vepruar si person kontakti sipas Përfaqësuesit të Kredisë së Eksportit.

Adresa ime në Vjenë: ……
Në rast ndryshimi të adresës, do t'ju njoftoj me shkrim pa vonesë.

Me respekt

……
Ambasada e
Republikës së Shqipërisë në Austri
vendi, data ……

LIGJ
Nr.10 472, datë 20.10.2011

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7145, datë 31.10.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS MBI TRANSPORTIN NDËRKOMBËTAR RRUGOR TË UDHËTARËVE DHE MALLRAVE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, këtu e tutje të përmendura si Palë Kontraktuese;

me dëshirën për të kontribuar për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike midis dy vendeve;

të vendosur për të nxitur bashkëpunimin e transportit rrugor në kuadër të ekonomisë së tregut;

të shqetësuar për mbrojtjen e mjedisit dhe njerëzve, përdorimin racional të energjisë, sigurinë në rrugë dhe përmirësimin e kushteve të punës së drejtuesve të automjeteve;

të prirur për zhvillimin e transportit intermodal;

duke njohur avantazhin e dyanshëm të zhvillimit të transportit rrugor;

duke pasur parasysh procesin europian të liberalizimit i cili kontribuon në lëvizjen e lirë të mallrave dhe shërbimeve, si dhe lëvizjen e lirë të njerëzve,

kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje shërbejnë për transportin rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve ndërmjet, në dhe transit përmes territoreve të Palëve Kontraktuese, dhe për në ose nga vendet e treta, të kryera nga transportues të vendosur në territorin e njërës prej palëve kontraktuese.

Kjo marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga marrëveshje të tjera ndërkombëtare që kanë firmosur Palët Kontraktuese.

Neni 2
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë marrëveshje kanë kuptimet e mëposhtme:

1. “Operator transporti” nënkupton çdo person fizik ose juridik i vendosur në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese dhe i autorizuar për të kryer transportin e udhëtarëve ose mallrave me qira ose për të tretë ose për llogari të vet në përputhje me ligjet dhe rregullat e caktuara kombëtare.

2. “Mjet” nënkupton një mjet motorik ose kombinim mjetesh, ku të paktën mjeti motorik është regjistruar në territorin e njërës nga Palët Kontraktuese dhe i cili përdoret ekskluzivisht për transportimin e mallrave.

3. “Transport” nënkupton lëvizjen e mjetit, me ose pa ngarkesë, edhe nëse mjeti motorik, rimorkio ose gjysmërimorkio transportohet me tren për një pjesë të udhëtimit.

4. “Transporti ndërkombëtar i mallrave” nënkupton:

a) një udhëtim të ndërmarrë me anë të një mjeti, ku pika e nisjes është në territorin e njërës Palë Kontraktuese dhe pika e mbërritjes është në territorin e Palët tjetër Kontraktuese, me ose pa transit të një ose më shumë vendeve të treta;

b) një udhëtim i ndërmarrë me anë të një mjeti nga territori i një Pale Kontraktuese të një vendi të tretë ose *vice versa*, me ose pa transit, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese;

c) një udhëtim i ndërmarrë me anë të një mjeti ndërmjet vendeve të treta, transit përmes territorit të një ose dy Palëve Kontraktuese;

ç) një udhëtim pa ngarkesë në lidhje me transportet e përmendura në shkronjat "a", "b" dhe "c".

5. "Kabotazhi" nënkupton operacionin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave të ngarkuara në një pikë të territorit të një Pale Kontraktuese dhe shkarkimin e tyre në një pikë tjetër të territorit të së njëjtës Palë Kontraktuese, me anë të një mjeti të regjistruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

6. "Territori i njërës Palë Kontraktuese" nënkupton përkatësisht territorin e Republikës së Shqipërisë dhe territorin e Republikës së Kosovës.

7. "Vendi i vendosjes" nënkupton territorin e Palës Kontraktuese në të cilin është vendosur operatori i transportit dhe mjeti motorik është i regjistruar.

8. "Vendi pritës" nënkupton territorin e një Pale Kontraktuese, në të cilin një operator transporti operon përveç territorit të Palës Kontraktuese të vendosjes së operatorit.

9. "Autobus" nënkupton një mjet me më shumë se nëntë vende, që përfshin dhe drejtuesin e mjetit, i konstruktuar dhe i pajisur për transportin e udhëtarëve dhe bagazheve të tyre, dhe i cili është i regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese;

10. "Shërbimi i rregullt i udhëtarëve" nënkupton një shërbim ku udhëtarët transportohen në intervale të specifikuara përgjatë itinerareve të specifikuara, ku udhëtarët hipin ose zbriten në vendndalime të përcaktuara më parë.

11. "Shërbimet e rregullta, të specializuara" nënkuptojnë shërbimet me autobus, të organizuara nga operatori i transportit, që siguron transportin e një kategorie të specifikuar udhëtarësh, me përjashtim të udhëtarëve të tjerë.

Shërbimet e rregullta të specializuara do të përfshijnë:

- Transportin punë-shtëpi të punonjësve;
- Transportin e nxënësve të shkollave dhe studentëve për në dhe nga institucionet edukuese;
- Transportet urbane të zonave kufitare.

Fakti që një shërbim i rregullt, i specializuar mund të ndryshojë në përputhje me nevojat e përdoruesve nuk do të ndikojë në klasifikimin e tij si një shërbim i rregullt.

12. "Shërbimet e rastit" nënkuptojnë shërbimet të cilat nuk përkojnë me përkufizimin e shërbimeve të rregullta, përfshirë edhe shërbimet e rregullta të specializuara, dhe të cilat karakterizohen të gjitha nga fakti, që ato mbartin grupe të udhëtarëve të mbledhur, me iniciativën e klientëve ose të vetë transportuesit.

13. "Transporti për llogari të vet" nënkupton:

a) Rastin e transportit të udhëtarëve, ku transporti kryhet për qëllime jotregtare dhe jofitimprurëse nga operatorët e transportit, me kusht që:

- aktiviteti i transportit është vetëm një aktivitet ndihmës për operatorin e transportit;
- mjetet që përdoren janë në pronësi të operatorit të transportit ose të vendosura në dispozicion të tij nëpërmjet një kontrate me qira ose *leasing* dhe drejtohen nga anëtarë të personelit të operatorit të transportit ose nga vetë operatori i transportit;

b) Rastin e transportit të mallrave për llogari të vet, kur plotësohen kushtet si më poshtë:

i) mallrat e transportuara duhet të jenë pronë e ndërmarrjes ose duhet të jenë të shitura, të blera, të dhëna ose të marra me qira, të prodhuara, të nxjerra, të përpunuara ose të riparuara nga ndërmarrja;

ii) qëllimi i udhëtimit duhet të jetë transporti i mallrave në ose nga ndërmarrja, ose për lëvizjen e tyre, ose brenda ndërmarrjes, ose jashtë për kërkesat e vetë asaj;

iii) mjetet motorike për transporte të tilla duhet të drejtohen nga punonjësit e ndërmarrjes;

iv) mjetet që transportojnë mallrat duhet të jenë pronë e ndërmarrjes ose të jenë blerë nga ajo me këste ose të marra me qira pa drejtues mjeti;

v) transporti duhet të jetë ndihmës në të gjitha veprimtaritë e ndërmarrjes.

14. "Dokumenti i kontrollit" nënkupton dokumentet sipas nenit 14 të kësaj marrëveshjeje.

15. "Licencë transporti ndërkombëtar" nënkupton të drejtën për të kryer veprimtari transporti ndërkombëtar të udhëtarëve ose mallrave, për të tretë ose me qira.

16. "Autorizimi/leja" nënkupton dokumentin, e lëshuar nga autoriteti kompetent i secilës prej Palëve Kontraktuese që garanton të drejtën/mundësinë që mjeti i regjistruar në territorin e Palës tjetër Kontraktuese të kryejë udhëtim për në ose përmes territorit të Palës Kontraktuese ku është lëshuar autorizimi/leja.

17. "Transiti" nënkupton transportin e udhëtarëve dhe/ose mallrave nga mjeti i regjistruar në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese.

18. Termi "Mallra të rrezikshme" nënkupton mallra që për nga cilësia, vetitë dhe tiparet e tyre karakteristike, kur transportohen, ngarkohen, shkarkohen dhe magazinohen, mund të shkaktojnë dëme te pajisjet, ndërtesat dhe ndërtimet, si dhe të shkaktojnë vdekjen, plagosjen ose sëmundjen e njerëzve, kafshëve dhe dëmeve në mjedis.

PJESA II
TRANSPORTI I UDHËTARËVE

Neni 3
Hyrja në treg
Shërbimet e rregullta

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve që kryhen ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese ose në transit përmes territoreve të tyre i nënshtrohen sistemit të autorizimeve.

2. Kërkesa për autorizim paraqitet tek autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, ku është i vendosur operatori dhe është i regjistruar mjeti, i cili mund ta pranojë atë ose jo. Në rast se kërkesa pranohet, autoriteti i lartpërmendur do të komunikojë me autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese.

3. Vendimi për të dhënë ose refuzuar lëshimin e autorizimit merret brenda një kohe prej 30 ditësh, me përjashtim të rrethanave të veçanta.

Komiteti i përbashkët, i ngritur në bazë të nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje, si më poshtë, vendos për modelin, periudhën e operimit dhe vlefshmërisë së autorizimit, si dhe të dokumenteve të tjera të nevojshme.

Autorizimet e shërbimeve të rregullta do të specifikojnë, si vijon:

a) llojin e shërbimit;

b) itinerarin e shërbimit, duke dhënë në mënyrë të veçantë pikën e nisjes dhe pikën e mbërritjes;

c) periudhën e vlefshmërisë së autorizimit dhe periudhën e operimit.

ç) stacionet dhe tabelën e orareve.

4. Ndryshimet e kushteve operuese dhe anulimi i shërbimit vendoset sipas procedurave të përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Shërbimet e rregullta të specializuara, sipas përkufizimit në pikën 11 të nenit 2, nuk janë subjekt për autorizim, por janë subjekt kontrolli i kontratës së lidhur ndërmjet organizatorit dhe transportuesit. Në rast se nuk ka më kërkesa për këtë shërbim, operatori i transportit mund ta kërkojë anulimin nga ana e autoritetit kompetent, duke njoftuar tre muaj më parë autoritetin kompetent, i cili e ka lëshuar autorizimin, dhe klientët.

Neni 4

Shërbimi i rregullt brenda territorit të një Pale Kontraktuese përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese

1. Shërbimet e rregullta të udhëtarëve me autobus, që kryhen nga territori i njërës Palë Kontraktuese, transit, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese për në territorin e Palës së parë Kontraktuese, nuk janë subjekt autorizimi të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palës tjetër Kontraktuese.

2. Shërbimet e rregullta, brenda vendit të udhëtarëve me autobus, të një Pale Kontraktuese, transit, përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese do të kryhen kur plotësohen kushtet, si vijojnë:

a) Pikat e hyrjes në dhe dalje dhe nga territori i Palës tjetër Kontraktuese janë të ndryshme.

b) Itinerari i udhëtimit që përshkruhet nga mjetet e një Pale Kontraktuese në territorin e Palës tjetër Kontraktuese do të kryhet në segmentin rrugor që ndodhet më pranë kufirit të të dyja Palëve Kontraktuese.

c) Ky shërbim në këtë segment rrugor duhet të kryhet me dyer të mbyllura.

3. Në rastin e një shërbimi të tillë, autoriteti kompetent në pikën e nisjes dhe të mbërritjes i dërgon autoritetit kompetent të Palës tjetër Kontraktuese një kopje të kërkesës së bashku me vlerësimin e tij dhe dokumentet që e shoqërojnë. Ky autoritet kompetent jep mendimin e tij brenda 30 ditëve me marrjen e kërkesës.

4. Këto lloj shërbimesh të rregullta janë të vlefshme si për operatorët e shërbimeve të rregullta ndërkombëtare të udhëtarëve, ashtu edhe për operatorët e shërbimeve të rregullta brenda vendit.

5. Operatori i transportit të një Pale Kontraktuese, i cili kryen itinerarin e tij pjesërisht përmes territorit të Palës tjetër Kontraktuese, duhet të zbatojë ligjet dhe rregullat që janë në fuqi për transportin rrugor në Palën tjetër Kontraktuese.

6. Koha e nevojshme për kontrollet e udhëtarëve dhe bagazheve në pikat e kalimit të kufirit nuk duhet të jetë më e gjatë se një kontroll rutinë i zhvilluar nga organet e kontrollit në rrugë brenda territorit të një Pale Kontraktuese.

7. Operatori i transportit duhet të jetë i pajisur me dokumentet e nevojshme sipas nenit 14 gjatë kryerjes së operimit.

8. Komiteti i përbashkët i ngritur në bazë të nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje vendos për dokumentet plotësuese të nevojshme që duhet të jetë i pajisur operatori i transportit.

Neni 5

Shërbimet e rastit

1. Shërbimet e rastit të udhëtarëve që kryhen ndërmjet territoreve të Palëve Kontraktuese dhe në transit përmes territoreve të tyre të kryera me anë të autobusëve duhet të shoqërohen me një

dokument udhëtimi të lëshuar nga autoriteti kompetent i Palëve Kontraktuese ku është vendosur operatori i transportit. Kushtet e përdorimit dhe përmbajtja e dokumentit të udhëtimit (lista e udhëtarëve) përcaktohen nga komiteti i përbashkët i ngritur sipas nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje. Dokumenti i udhëtimit të udhëtarëve, i plotësuar tërësisht, do të mbahet në mjet gjatë gjithë udhëtimit.

Neni 6
Transporti për llogari të vet

1. Transporti për llogari të vet është i përjashtuar nga autorizimi, por është subjekt i certifikatës.

2. Certifikatat do të lëshohen nga organet e ngarkuara në Palën Kontraktuese, ku operatori i transportit është i vendosur dhe do të jenë të vlefshme për udhëtimet në hyrje që përfshin edhe transitin në vendin pritës.

3. Autoritetet kompetente të të dyja Palëve Kontraktuese do të njohin certifikatat e transportit të udhëtarëve të lëshuara nga organet e ngarkuara në Palën Kontraktuese, ku operatori i transportit është i vendosur.

PJESA III
TRANSPORTI I MALLRAVE

Neni 7
Hyrja në treg

1. Marrëveshja do të zbatohet për transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave për në, nga ose përmes territorit të një ose të dyja Palëve Kontraktuese, kur këta operatorë transporti janë të licencuar nga organet e ngarkuara në Palën Kontraktuese, ku operatori i transportit është i vendosur në kryerjen e kësaj veprimtarie.

Transporti ndërkombëtar i mallrave do të kryhet në bazë të licencës për transportin ndërkombëtar të mallrave për të tretë ose me qira.

2. Licenca i lëshohet operatorit të transportit nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese, në rastin kur ai:

- është i vendosur në territorin e kësaj Pale Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e saj;
- është pranuar në veprimtarinë e transportit për të kryer transport ndërkombëtar të mallrave me rrugë nga autoritetet kompetente të Palës Kontraktuese në përputhje me legjislacionin e komunitetit europian dhe legjislacionin kombëtar të kësaj Pale Kontraktuese.

3. Të dyja Palët Kontraktuese do të njohin licencat e transportit ndërkombëtar të mallrave për të tretë ose me qira, të lëshuara nga organet e ngarkuara në Palën Kontraktuese, ku operatori i transportit është i vendosur.

4. Licencat lëshohen pa afat ose me afat jo më të vogël se pesë vjet dhe me të drejtë rinovimi për një periudhë të njëjtë.

5. Licenca është personale dhe e patransferueshme te palët e treta.

6. Transporti për/nga vendet e treta i nënshtrohet sistemit të lejeve.

7. Komiteti i përbashkët do të përcaktojë modelin dhe numrin e lejeve.

Neni 8
Transportet që nuk janë subjekt licence

Ndryshe nga dispozitat e nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje, licencat e lëshuara nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese nuk janë të detyrueshme në rastet si vijon:

1. Për transportin ndërkombëtar të mallrave për të tretë ose me qira dhe për llogari të vet, si vijon, kur transporte të tilla kryhen për në, nga ose transit përmes territorit të tyre:

a) transporti i mallrave me mjete rrugore me motor, pesha e përgjithshme e lejueshme me ngarkesë e të cilit, duke përfshirë dhe rimorkiot, nuk i kalon 6 tonë, ose ku ngarkesa e dobishme e lejuar, përfshirë rimorkiot, nuk kalon 3.5 tonë;

b) transportin, sipas rastit, për në ose nga aeroportet në rastet kur ka devijime të shërbimeve ajrore;

c) transportin e mjeteve që janë dëmtuar ose kanë dalë jashtë përdorimit dhe udhëtimet e mjeteve për riparimin e tyre;

ç) udhëtimet pa ngarkesë të mjetit të mallrave të dërguar për zëvendësimin e mjetit të dëmtuar, si dhe kthimin e tij, pas riparimit të mjetit të dëmtuar;

d) transportin e mjeteve për produktet e pajisjet mjekësore të nevojshme në raste urgjence, në mënyrë të veçantë, për rastet e fatkeqësive natyrore dhe, gjithashtu, për të dhënë një ndihmë humanitare;

dh) transportin e veprave dhe objekteve të artit për panaire dhe ekspozita ose për qëllime jotregtare;

e) transportin për qëllime jotregtare të pasurive, aksesorëve dhe kafshëve për në dhe nga shfaqje dhe panaire teatrore, muzikore, filma, sporte ose cirku, dhe ato që janë të destinuara për regjistrime në radio ose prodhime filmike apo televizive;

ë) heqje të pajisjeve shtëpiake të kryera nga kompani me personel të specializuara dhe pajisjeve për këtë qëllim;

f) transportin funeral;

g) transportin postar të kryer si një shërbim publik;

gj) transportin e bletëve dhe peshkut të gjallë.

Për transportin e mallrave me mjete motorike për llogari të vet, nëse plotësohen kushtet pas shkronjës “b” të pikës 13 të nenit 2, për transportin e mallrave me mjete rrugore me motor, pesha e përgjithshme e lejuar me ngarkesë e të cilit, duke përfshirë dhe rimorkiot, i kalon 6 tonë, ose kur ngarkesa e dobishme e lejuar, përfshirë rimorkiot i kalon 3.5 tonë.

Komiteti i përbashkët i ngritur sipas nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje, mund të shtojë ose heqë, nga lista e kategorive të transportit të përjashtuara nga licenca, edhe lloje të tjera të transportit të mallrave.

Neni 9
Kabotazhi

Operatorët e transportit të licencuar për të tretë ose me qira dhe të licencuar/pajisur me certifikatë për transportin për llogari të vet në transportin ndërkombëtar të mallrave, lejohen të kryejnë kabotazh me autorizim/leje të veçantë të autoritetit kompetent të Palës Kontraktuese pritëse.

Leja/autorizimi për kryerjen e operacionit të kabotazhit shoqërohen me librin e udhëtimeve dhe fletët e plotësuara të këtij libri do të kthehen tek autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese të vendosjes, i cili e ka lëshuar lejen/autorizimin, brenda tetë ditëve nga data e përfundimit të afatit të vlefshmërisë.

Leja/autorizimi i kabotazhit do të lëshohen në emër të transportuesit, i cili nuk lejohet ta transferojë te palët e treta. Secili autorizim do të përdoret nga një mjet në të njëjtën kohë.

Modeli i autorizimit, dokumentacionit shoqërues, procedurat dhe tarifat për autorizimin/lejen e kabotazhit miratohen nga komiteti i përbashkët sipas nenit 17 të Marrëveshjes.

Kur operacionet e kabotazhit kryhen pa lejen e nevojshme ose në kundërshtim me legjislacionin për transportin rrugor në territorin e Palës Kontraktuese pritëse, transportuesi i Palës Kontraktuese, ku është i vendosur transportuesi, dënohet sipas legjislacionit të Palës Kontraktuese pritëse, ku kryhet operacionit i kabotazhit, si dhe kjo e fundit, menjëherë, njofton autoritetin kompetent të Palës Kontraktuese, ku është i vendosur transportuesi, për masën e marrë.

Në rastin e çrregullimeve të tregut të brendshëm në transport, në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese, për shkak të kabotazhit, cilado Palë Kontraktuese njofton komitetin e përbashkët sipas nenit 17 për këtë qëllim. Komiteti i përbashkët do të mblidhet me marrjen e këtij njoftimi dhe pas shqyrtimit, vendos për masat që duhet të ndërmerren, të cilat mund të arrijnë deri në pezullimin e operacioneve të kabotazhit për një periudhë jo më të gjatë se gjashtë muaj.

PJESA IV
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 10
Çështje financiare

1. Mjetet që realizojnë transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave, udhëtarëve dhe bagazheve të tyre e që janë regjistruar në territorin e Palës Kontraktuese dhe që ndodhen përkohësisht në territorin e Palës tjetër Kontraktuese përjashtohen nga pagesa e taksave lidhur me pronësinë, regjistrimin dhe qarkullimin e mjetit sipas kushteve të kësaj Marrëveshjeje.

2. Karburanti i vendosur në depozitat normale të mjetit të ndërtuar për këtë qëllim dhe që përdoret për funksionimin e mjetit ose për funksionimin e pajisjeve për kontrollin e temperaturës, ashtu si dhe për lubrifikantët e vendosur në mjete, me qëllimin e vetëm funksionimin e tyre, do të jenë reciprokisht të përjashtuar nga detyrimet doganore dhe çdo taksë dhe pagesë tjetër.

3. Nuk përjashtohen taksat dhe detyrimet mbi karburantit e motorit, tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH) në operacionet e transportit; detyrimet për pagesat e segmenteve të veçanta rrugore, urave; taksat e përdorimit dhe tarifat për leje të veçanta, ashtu si parashikohet në nenin 12 të kësaj Marrëveshjeje.

4. Tarifat e lëshimit të lejeve/autorizimeve i nënshtrohen legjislacionit të secilës Palë Kontraktuese, nëse në Marrëveshje nuk përcaktohet ndryshe.

Neni 11
Marrëdhëniet doganore

1. Pjesët e ndërrimit, të nevojshme për riparimin e një mjeti, tashmë do të pranohen përkohësisht nën emrin e importimit të përkohshëm pa pagesë të detyrimeve doganore dhe taksave të tjera, dhe pa pengesa dhe kufizime të importit.

2. Pjesët e zëvendësuara duhet të pastrohen, rieksportohen ose shkatërrohen nën kontrollin dhe vëzhgimin e nëpunësve të doganës.

Neni 12
Pesha dhe përmasat

1. Pesha maksimale e lejuar, pesha për akset dhe dimensionet e mjeteve nuk duhet të kalojnë ato të shënuara në dokumentet e regjistrimit dhe as në kufijtë më të lartë të lejueshëm në fuqi në vendin pritës.

2. Përdorimi i mjeteve, pesha dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë maksimalë të lejueshëm, lejohet në vendin pritës vetëm me leje (autorizim) të veçantë të lëshuar paraprakisht.

3. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese informojnë reciprokisht njëra-tjetrën për institucionet që lëshojnë lejen (autorizimin) e veçantë në këtë lloj transporti dhe tarifat përkatëse që duhet të paguajnë operatorët e transportit.

4. Në përputhje me pikën 2, kërkesa për një leje të veçantë për mjetet që transportojnë mallra, pesha dhe përmasat e të cilave i kalojnë kufijtë e lejuar në territorin e Palës Kontraktuese pritëse, duhet të përmbajë:

a) emrin dhe adresën e operatorit;
b) prodhuesin e mjetit, tipin dhe targat;
c) numrin e akseve dhe shpërndarjen e akseve;
ç) përmasat dhe peshën e mjeteve;
d) kapacitetin e ngarkimit;
dh) përmasat dhe peshën e mallrave;
e) në qoftë se është e nevojshme, përshkrimin e mjetit, së bashku me mallrat;
ë) ngarkesën për çdo aks;
f) adresën e vendit të ngarkimit dhe shkarkimit;
g) vendin e planifikuar të kalimit kufitar dhe datën, si dhe itinerarin.

Neni 13
Pajisjet dhe karakteristikat e tjera

Të dyja Palët Kontraktuese do të njohin në mënyrë reciproke certifikatat e inspektimit teknik të mjeteve, lejet e drejtimit dhe lejet e qarkullimit, certifikatat e ADR për drejtuesit e mjeteve, të lëshuara nga autoritetet kompetente respektive.

Të dyja Palët do të njohin certifikatat e kompetencës profesionale për drejtues veprimtarie të ndërmarrjeve të transportit dhe certifikatat e aftësimit profesional për drejtuesit e mjeteve, të lëshuara nga autoritetet kompetente respektive.

Komiteti i përbashkët i ngritur sipas nenit 17 të kësaj Marrëveshjeje mund të zgjerojë listën e dokumenteve të cilat janë subjekt i njohjes reciproke nga Palët Kontraktuese në këtë Marrëveshje.

Mjetet që transportojnë mallra të rrezikshme duhet të jenë të përshtatshme dhe të pajisura në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes europiane lidhur me transportin ndërkombëtar rrugor të mallrave të rrezikshme, të 30 shtatorit 1957, të ndryshuar (ADR).

Pajisjet që përdoren për të kontrolluar kohën e drejtuesve të mjetit duhet të përputhen me dispozitat e Marrëveshjes europiane lidhur me punën e ekuipazheve të automjeteve të angazhuara në transportin ndërkombëtar rrugor, të 1 korrik 1970, të ndryshuar (AETR).

Mjetet që transportojnë mallra që prishen shpejt duhet të sigurohen dhe pajisen në përputhje me nevojat e Marrëveshjes europiane në lidhje me transportin ndërkombëtar të ushqimeve delikate dhe pajisjet speciale të përdorura në këto transporte (ATP), e 1 shtatorit 1970, të ndryshuar.

Palët Kontraktuese ndërmarrin promovime në përdorimin e mjeteve që plotësojnë standardet ndërkombëtare të sigurisë dhe mjedisit.

Neni 14
Dokumentet e kontrollit

Lejet/autorizimet, licencat dhe, ose certifikatat e mjeteve, shënimet e ngarkesës, lista e udhëtarëve (dokumenti i udhëtimit) dhe çdo dokument tjetër në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe siguracionet, certifikatat e trajnimit, dhe të gjitha dokumentet e tjera që kërkohen në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare shumëpalëshe dhe, ose sipas legjislacionit kombëtar të Palëve Kontraktuese në këtë Marrëveshje, janë subjekt për kontroll e duhet të mbahen në mjet dhe u paraqiten zyrtarëve të kontrollit të autorizuar sa herë kërkohen prej tyre.

Neni 15
Detyrimet e operatorëve të transportit dhe shkeljet

1. Operatorët e transportit të vendit të Palës Kontraktuese dhe ekuipazhet e mjeteve duhet të veprojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi të atij vendi kur ndodhen në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.

2. Në rast të ndonjë shkeljeje të dispozitave të kësaj Marrëveshjeje nga operatori i transportit të vendit të Palës Kontraktuese, autoriteti kompetent i Palës Kontraktuese, në territorin e së cilës ndodhi shkelja, pa paragjykuar procedimet ligjore të atij vendi, duhet të njoftojë autoritetin kompetent të Palës tjetër Kontraktuese, i cili do të marrë masa siç janë parashikuar nga legjislacioni kombëtar i atij vendi. Në raste veçanërisht të rënda, autoriteti kompetent i vendit pritës mund të ndalojë përkohësisht hyrjen në territorin e vendit të tij, duke pritur një vendim nga autoriteti kompetent në vendin e vendosjes. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese duhet ta informojnë njeri-tjetrin, reciprokisht, për vendimet e marra.

3. Palët Kontraktuese do t'i japin njëra-tjetrës asistencë reciproke në zbatimin dhe monitorimin e kësaj Marrëveshjeje. Ato do të shkëmbejnë informacion nëpërmjet autoriteteve kompetente respektive të caktuara në nenin 18.

Neni 16
Pikat e përbashkëta të kontrollit në lehtësirat e procedurave të kalimeve kufitare

Me qëllim garantimin e formaliteteve të nevojshme, që pikat e kalimit të kufirit të jenë sa më efektive dhe intensive, Palët Kontraktuese do të plotësojnë në pikat e kalimit të kufirit për transportit ndërkombëtar të mallrave kërkesat minimale si vijon:

a) mjedise që mundësojnë kontrollin e përbashkët ndërmjet të dyja Palëve Kontraktuese (*one -stop technology*), 24 orë në ditë e justifikuar nga nevojat e punës dhe rregullat e trafikut rrugor;

b) ndarjen e trafikut për lloje të ndryshme të trafikut në të dyja anët e kufirit që u lejon dhënien e prioriteteve mjeteve të cilat kanë dokumente të vlefshme për transit në doganat ndërkombëtare ose mjeteve që transportojnë kafshë të gjalla ose ushqime që prishen shpejt, dhe mjeteve të transportit të udhëtarëve;

c) zonat e kontrollit në korsi të veçanta (*offline*) për kontrollet e rastit për ngarkesën dhe mjetin;

ç) lehtësirat e parkimit të përshtatshëm dhe stacionimi;

d) mjedise (lehtësira) çlodhjeje, higjienë dhe ndërlidhje për drejtuesit e mjeteve;

dh) përkrahjen ose mbështetjen e agjentëve spedicionerë në vendosjen e mjediseve të përshtatshme në pikat e kalimit të kufirit, me synimin që ato të mund t'u ofrojnë shërbime operatorëve të transportit.

Neni 17
Komiteti i përbashkët

1. Autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese do të rregullojnë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin dhe përdorimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Për këtë qëllim Palët Kontraktuese do të ngrenë një komitet të përbashkët.

3. Komiteti i përbashkët do të mblidhet rregullisht çdo vit me kërkesë të njërës Palë Kontraktuese, në mënyrë reciproke, në territorin e njërës prej Palëve Kontraktuese. Në takimet e komitetit të përbashkët do të ketë përfaqësues të autoriteteve kompetente të administratës së Palëve Kontraktuese, të cilat mund të ftojnë përfaqësues të shoqatave të transportit rrugor.

4. Komiteti i përbashkët duhet të përcaktojë procedurat dhe rregullat e veta. Takimi duhet të përfundojë me hartimin e një protokolli që do të firmoset nga kryetarët e delegacioneve të secilës Palë Kontraktuese.

5. Komiteti i përbashkët do të vendosë për kushtet e lëshimit, përdorimit, përmbajtjen e tipit të lejeve ose autorizimeve dhe kushtet e hyrjes në treg të operatorëve të transportit rrugor. Komiteti i përbashkët mund të zgjerojë llojet e transportit për të cilat nuk kërkohen licencë, leje ose autorizime.

6. Komiteti i përbashkët do të tregojë vëmendje të veçantë për çështjet e mëposhtme:

- Zhvillimin harmonik të transportit ndërmjet Palëve Kontraktuese, duke pasur parasysh ndërmjet të tjerave aspektet mjedisore të përfshira;
- Koordinimin e politikave të transportit, legjislacionit të transportit dhe zbatimin e tij nga Palët Kontraktuese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar;
- Formulimin e zgjidhjeve të mundshme për autoritetet respektive kombëtare, nëse ka probleme, veçanërisht në fushën e taksave, sociale , çështjet doganore dhe mjedisore, duke përfshirë çështjet e rendit publik që ndikojnë në operimet e transportit;
- Shkëmbimin e informacionit përkatës;
- Metodën e përcaktimit të përmasave dhe peshave;
- Nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet ndërmarrjeve dhe institucioneve të transportit;
- Nxitjen e transportit të kombinuar, që përfshin të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me hyrjen në treg;
- Ecurinë e progresit të bërë në procedurën e kalimit të pikave kufitare.

Neni 18
Autoritetet kompetente

1. Autoritetet kompetente për implementimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

Për Republikën e Kosovës, Ministria e Infrastrukturës.

Për Republikën e Shqipërisë, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

2. Në rast ndryshimesh të autoriteteve kompetente siç është shprehur në këtë paragraf, masat e autoriteteve kompetente i komunikohen Palës tjetër Kontraktuese nëpërmjet kanaleve diplomatike.

PJESA V
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 19
Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e Marrëveshjes

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi 30 ditë pas marrjes së njoftimit të fundit me shkrim, me anë të të cilit Palët Kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën që procedurat e tyre të brendshme ligjore të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi kanë përfunduar.

2. Kjo marrëveshje mbetet në fuqi për një periudhë kohe të pacaktuar. Secila nga Palët Kontraktuese mund ta denoncojë atë me anë të një njoftimi me shkrim. Marrëveshja zgjidhet tre muaj pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë.

3. Në të njëjtën kohë, marrëveshja e datës 17.6.2002 "Për transportin rrugor ndërkombëtar të mallrave dhe udhëtarëve, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes së Kosovës", shfuqizohet.

Në dëshmi të kësaj, të nënshkruarit, duke qenë të autorizuar, siç duhet për këtë, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në Prishtinë, më 22.7.2011, në dy kopje origjinale në gjuhën shqipe.

UDHËZIM
Nr.3, datë 5.10.2011

PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË OBJEKTEVE, TË NDËRTUARA ME LEJE NDËRTIMI TË PRAPAMBETURA NË BASHKINË E TIRANËS, NË ZYRËN E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 56 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar, dhe të nenit 18 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë dhe të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjitha objektet e ndërtuara në bazë të lejeve të ndërtimit në njësinë vendore, Tiranë, të lëshuara në zbatim të ligjit nr.8405, datë 17.9.1998 "Për urbanistikën", të ndryshuar, apo të ligjit nr.7693, datë 6.4.1993 "Për urbanistikën" (i shfuqizuar), të cilat nuk figurojnë të regjistruara në regjistrat e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sipas aneksit bashkëlidhur këtij udhëzimi, do të regjistrohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, në varësi të problematikës, si më poshtë vijon:

a) Objektet, për të cilat nuk është lëshuar leje shfrytëzimi, dhe pse është paraqitur kërkesë nga subjekti i interesuar pranë zyrës apo seksionit të urbanistikës së organit të qeverisjes vendore;

b) Objektet, për të cilat nuk është lëshuar leje shfrytëzimi dhe nuk është paraqitur kërkesë për leje shfrytëzimi nga subjekti i interesuar pranë zyrës apo seksionit të urbanistikës së organit të qeverisjes vendore;

c) Objektet, për të cilat është lëshuar leje shfrytëzimi, por kjo e fundit nuk rezulton të jetë përcjellë për regjistrim pranë ZRPP-së;

ç) Objektet, për të cilat është lëshuar leje shfrytëzimi dhe kjo e fundit është përcjellë për regjistrim pranë ZRPP-së.

2. "Subjekte të interesuara", në kuptim të dispozitave të këtij udhëzimi, janë:

a) Personi fizik apo juridik i përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit;

b) Personi fizik apo juridik, i cili paraqet një akt noterial të lidhur ndërmjet tij, në cilësinë e porositësit, dhe subjektit të përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit, me anë të të cilit janë marrë përsipër nga ky i fundit që, në këmbim të pagesës së një çmimi të caktuar, të ndërtojë për llogari të porositësit njësi individualisht të përcaktuara të objektit të ndërtuar me lejen përkatëse të ndërtimit;

c) Personi fizik apo juridik, në pronësi të të cilit figuron i regjistruar trualli, i cili përbën sheshin e ndërtimit mbi të cilin është ngritur objekti me leje ndërtimi.

3. Identifikimi i rasteve të përcaktuara në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrat e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, do të kryhet nga:

a) Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, për rastet e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij kreu;

b) ZRPP-ja dhe Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, për rastet e përcaktuara në shkronjën "c" të pikës 1 të këtij kreu;

c) ZRPP-ja, për rastet e përcaktuara në shkronjën "ç" të pikës 1 të këtij kreu.

KREU II
REGJISTRIMI I OBJEKTEVE PËR TË CILAT NUK ËSHTË LËSHUAR LEJE SHFRYTËZIMI

1. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet, për të cilat janë lëshuar leje ndërtimi, janë paraqitur kërkesa për lëshimin e lejeve të shfrytëzimit dhe këto të fundit nuk rezultojnë të jenë lëshuar, do të procedohet, si më poshtë vijon:

a) Kur konstatohet se kërkesa për leje shfrytëzimi nuk është trajtuar për mungesë të dokumentacionit që vërteton kryerjen e pagesave të taksave apo tatimeve për objektin, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, vijon procedurat e lëshimit të lejes së shfrytëzimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, dhe njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për detyrimet e papaguara të objektit;

b) Kur konstatohet se kërkesa për leje shfrytëzimi nuk është trajtuar për shkak të shkeljeve të kondicioneve të lejes së ndërtimit dhe dosja nuk është përcjellë pranë ALUIZNI-t, e përcjell atë pranë këtij institucioni duke njoftuar subjektet e interesuara. ALUIZNI, kur konstaton se objekti është vetëdeklaruar brenda afateve ligjore dhe disponon aktin e vetëdeklarimit, procedon në përputhje me ligjin nr.9482,datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e zonave informale", të ndryshuar. Në të gjitha rastet kur objektet nuk janë vetëdeklaruar në afat, ALUIZNI mban detyrimin t'ia kthejë pa veprim dosjet përkatëse brenda 5 (pesë) ditëve Drejtorisë së Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, duke njoftuar dhe subjektet e interesuara.

1.1 Pas lëshimit të lejes së shfrytëzimit sipas shkronjës "a" të pikës 1 të kreut II, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, ia përcjell atë Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, së bashku me dokumentacionin e poshtëshënuar:

- Lejen e sheshit të ndërtimit;

- Lejen e ndërtimit;
- Aktin e kolaudimit;
- Planvendosjen e objektit;
- Dokumente të tjera që individualizojnë njësitë e objektit të ndërtuar (projekt, planimetritë e kateve etj.);
- Aktet noteriale të lidhura ndërmjet porositësve dhe subjektit të përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit, të paraqitura nga subjektet e interesuara;
- Kontratat e sipërmarrjes, të lidhura ndërmjet pronarëve të truallit dhe investitorit, nëse ka.

1.2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pas administrimit të dokumentacionit të përcjellë sipas pikës 1.1 të këtij kreu, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim të çdonjërit prej subjekteve të interesuara, bën regjistrimin e objektit sipas aktit të kolaudimit, për të cilin është lëshuar leja e shfrytëzimit.

1.3 Regjistrimi i pronësisë së njësive të individualizuara, pjesë përbërëse të objektit, do të bëhet në rastet e mëposhtme:

1.3.1 Kur ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, i cili individualizon pasuritë, që do të përfitojë pronari i truallit nga marrëveshja me investitorin, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Pasuritë e individualizuara në akt noterial regjistrohen në pronësi të pronarit të truallit;

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme, deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë regjistruara sipas shkronjave “a” dhe “b”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit;

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “b”, e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet, gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës “b”, ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.2 Kur ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, i cili përcakton përqindjen që do të përfitojë pronari i truallit në objekt, por nuk individualizon pasuritë që do të përfitojë ky i fundit nga marrëveshja me investitorin, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Procedohet me regjistrimin e të gjitha pasurive të individualizuara që përbëjnë këtë objekt, në bashkëpronësi të investitorit dhe pronarit të truallit, sipas pjesës në përqindje të përcaktuar në aktin noterial.

b) Për pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet porositësve dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, në kartelën/regjistrin e pasurisë së regjistruar tashmë në bashkëpronësi sipas shkronjës “a”, bëhet shënimi i ekzistencës së aktit noterial të lidhur ndërmjet subjektit porositës dhe investitorit. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhet në gjykatë. Deri në zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes, pasuria mbetet e regjistruar në bashkëpronësi të investitorit dhe pronarit të truallit me kufizimin e veprimeve mbi pasurinë.

1.3.3 Kur pronarët e regjistruar të truallit, në momentin e paraqitjes së akteve për regjistrimin e objektit, janë të ndryshëm pjesërisht ose plotësisht nga pronarët e truallit, me të cilët investitori ka marrëveshje për ndërtimin, regjistrimi i objektit do të kryhet sipas procedurave të parashikuara respektivisht në pikën 1.3.1 apo 1.3.2 të kreut II të këtij udhëzimi, por pjesa në përqindje apo pasuritë individualisht të përcaktuara të objektit, që u takojnë pronarëve të truallit, do të regjistrohet në pronësi të pronarëve të truallit që rezultojnë si të tillë në momentin e paraqitjes së akteve për regjistrimin e objektit.

1.3.4 Kur nuk ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, por trualli ku është ngritur objekti rezulton në pronësi private, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Objekti regjistrohet në një kartelë/regjistër, duke bërë shënimin në të se ky objekt është ngritur mbi një pasuri truall në pronësi të një subjekti të ndryshëm nga investitori apo me të cilin investitori nuk ka marrëveshje për ndërtimin. Shënimi për ekzistencën e objektit mbi truallin bëhet edhe në kartelën/regjistrin e truallit, duke njoftuar pronarin e truallit, nëse figuron i regjistruar, për këtë fakt. Ky shënim bëhet edhe në kartelat/regjistrat e njësive të individualizuara që përbëjnë objektin.

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë regjistruar sipas shkronjave “a” dhe “b”, do të regjistrohen në pronësi të investitorit;

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”.

Në rastet e parashikuara nga shkronja “b” e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës “b” ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.5 Kur nuk ka akt noterial të lidhur ndërmjet pronarit të truallit dhe investitorit, por trualli ku është ngritur objekti rezulton në pronësi shtetërore, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Objekti regjistrohet në një kartelë/regjistër, duke bërë shënimin në të se ky objekt është ngritur mbi një pasuri truall, në pronësi të shtetit. Shënimi për ekzistencën e objektit mbi truallin në pronësi shtetërore bëhet edhe në kartelën/regjistrin e truallit, duke njoftuar Avokaturën e Shtetit për këtë fakt. Ky shënim bëhet edhe në kartelat/regjistrat e njësive të individualizuara që përbëjnë objektin. Në rast se nuk ka një kartelë të veçantë ku rezulton i regjistruar trualli në pronësi shtetërore, ZRPP-ja procedon me regjistrimin e tij.

b) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve porositëse dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme;

c) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat nuk janë të regjistruara sipas shkronjës "b", do të regjistrohen në pronësi të investitorit dhe do të kufizohen deri në paraqitjen e një akti të fitimit të pronësisë mbi truallin ku është ngritur ndërtimi. Ky kufizim nuk i shtrin efektet për veprimet mbi pasuritë e regjistruara në favor të porositësve.

ç) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Në rastet e parashikuara nga shkronja "b" e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet, gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë i shkronjës "b", ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.6 Kur trualli ku është ngritur objekti është në pronësi të investitorit, do të veprohet, si më poshtë vijon:

a) Pasuritë e individualizuara sipas akteve noteriale të lidhura ndërmjet subjekteve/porositësve dhe investitorit, të përcjella nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, apo të paraqitura për regjistrim në ZRPP nga subjektet e interesuara, regjistrohen në pronësi të porositësit. Mosmarrëveshjet ndërmjet investitorit dhe porositësit zgjidhen në gjykatë. Në rast se ka konflikt gjyqësor ndërmjet palëve, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me procedurat e ligjit që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme deri në përfundimin e konfliktit gjyqësor. Në rast se nuk ka konflikt gjyqësor, regjistruesi vendos kufizimin e veprimeve në përputhje me afatin dhe procedurat e përcaktuara në ligjin që rregullon regjistrimin e pasurive të paluajtshme.

b) Pasuritë e individualizuara sipas aktit të kolaudimit, të cilat do të rezultojnë si të tilla pas regjistrimeve të kryera sipas shkronjës "a", do të regjistrohen në pronësi të investitorit.

c) ZRPP-ja lëshon certifikatën e pronësisë sipas përcaktimeve në aktin noterial, pasi verifikon elementet e formës dhe të përmbajtjes sipas udhëzimit nr.1, datë 31.1.2007 të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e regjistrimit në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme".

Në rastet e parashikuara nga shkronja "a" e kësaj pike, certifikata lëshohet pasi verifikohet gjithashtu, sipas rastit, edhe përmbushja e kushtit të parashikuar nga paragrafi i dytë, i shkronjës "a", ose përmbushja e afatit të parashikuar nga paragrafi i tretë i së njëjtës shkronjë.

1.3.7 Në rastet kur për një pasuri të individualizuar të objektit janë paraqitur për regjistrim dy ose më shumë akte noteriale të lidhura ndërmjet investitorit dhe subjekteve të ndryshme porositëse apo me pronarët e truallit, ZRPP-ja do të zbatojë përcaktimet e bëra në nenin 10 të ligjit nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", të ndryshuar.

2. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet, për të cilat janë lëshuar lejet e ndërtimit, nuk janë paraqitur kërkesat për lëshim të lejes së shfrytëzimit, njofton subjektin e përcaktuar si investitor në lejen e ndërtimit për paraqitjen e dokumentacionit të parashikuar në nenet 11 dhe 12 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e organeve të qeverisjes vendore", brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e njoftimit.

2.1 Në rastin kur brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, paraqitet kërkesë nga subjekti investitor, kjo kërkesë trajtohet sipas parashikimeve të bëra në pikën 1 të kreut II të këtij udhëzimi.

2.2 Në rastin kur nga subjekti investitor nuk paraqitet kërkesë sipas pikës 2 të këtij kreu, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, kryesisht apo me kërkesë të subjekteve të interesuara, verifikon dokumentacionin e administruar në dosjen e lejes së ndërtimit.

2.2.1 Kur nga verifikimi konstatohet se në dosjen e objektit ndodhet i administruar dokumenti i nevojshëm për lëshimin e lejes së shfrytëzimit, por mungon dokumentacioni i cili vërteton pagesat e detyrimeve tatimore për objektin, Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e

Tiranës, vijon procedurat për lëshimin e lejes së shfrytëzimit dhe dërgimit të saj në ZRPP sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1 shkronja "a", dhe 1.1 të kreut II, ndërsa ZRPP-ja procedon me regjistrimin sipas përcaktimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

2.2.2 Kur nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së lejes së ndërtimit konstatohet se objekti nuk mund të trajtohet me lëshim të lejes së shfrytëzimit për shkak të mungesës së aktit të kolaudimit, Drejtoria e Urbanistikës, në bashkinë e Tiranës, zgjidh çështjen e kolaudimit të objektit dhe përcakton personat e autorizuar për përgatitjen e këtij akti sipas përcaktimeve të bëra në nenin 12 të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar.

2.2.3 ALUIZNI dhe Enti Kombëtar i Banesave kanë detyrimin të mbështesin Drejtorinë e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, me të gjitha kapacitetet e tyre administrative për realizimin e parashikimeve të bëra në pikën 2.2.2., të këtij kreu.

KREU III
REGJISTRIMI I OBJEKTEVE PËR TË CILAT ËSHTË LËSHUAR LEJE SHFRYTËZIMI

1. Në rastet kur Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, konstaton se për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi janë lëshuar lejet e shfrytëzimit, brenda 5 (pesë) ditëve nga ky konstatim, informon Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, duke përcjellë te kjo e fundit një kopje të lejes së shfrytëzimit dhe një kopje të lejes së sheshit të ndërtimit.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e administrimit të lejeve të shfrytëzimit dhe të lejes së sheshit të ndërtimit, verifikon nëse objektet, për të cilat janë lëshuar leje shfrytëzimi, janë të regjistruara. Kur konstaton se objekti, për të cilin është lëshuar leja e shfrytëzimit, nuk është regjistruar dhe dokumentacioni, që i përket këtij objekti, nuk ndodhet i administruar në ZRPP, i kërkon Drejtorisë së Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, përcjelljen e dokumentacionit të parashikuar në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi. ZRPP-ja, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të këtij dokumentacioni, vijon procedurat për regjistrimin e objektit sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

3. Në rastet kur ZRPP-ja konstaton se lejet e shfrytëzimit ndodhen të administruara në ZRPP, por nuk rezulton të jetë kryer regjistrimi i objekteve, për të cilat ato janë lëshuar, procedon, si më poshtë vijon:

a) Vijon procedurat e regjistrimit të objektit kur konstaton se ndodhet i administruar i gjithë dokumentacioni i parashikuar në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi, referuar lejes së shfrytëzimit dhe aktit të kolaudimit, sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

b) Kur konstaton se mungon çdonjëri prej dokumenteve të parashikuara në pikën 1.1 të kreut II të këtij udhëzimi, brenda 5 (pesë) ditëve nga ky konstatim i kërkon zyrës/seksionit të urbanistikës përcjelljen e këtij dokumentacioni. Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës së ZRPP-së, ia dërgon kësaj të fundit dokumentacionin e kërkuar. Me administrimin e këtij dokumentacioni, ZRPP-ja vijon menjëherë procedurat e regjistrimit të objektit sipas parashikimeve të bëra në pikat 1.2 dhe 1.3 të kreut II të këtij udhëzimi.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

1. Identifikimi i rasteve të përcaktuara në pikën 1 të kreut I të këtij udhëzimi, do të bëhet nga subjektet e përcaktuara në pikën 3 të kreut I, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

2. Në të gjitha rastet e mosparaqitjes së dokumentacionit të nevojshëm nga investitori për lëshimin e lejes së shfrytëzimit për objektet, për të cilat janë lëshuar lejet e ndërtimit, pas njoftimit të kryer nga Drejtoria e Urbanistikës, në Bashkinë e Tiranës, sipas parashikimit të pikës 2 të kreut II të këtij udhëzimi, kjo e fundit, brenda 5 (pesë) ditëve nga kalimi i afatit, njofton organet e tatim - taksave për detyrimin financiar që këto subjekte i detyrohen shtetit me qëllim përmbushjen e tyre sipas parashikimeve ligjore.

3. Ngarkohen kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit, Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Drejtori i Përgjithshëm i Entit Kombëtar të Banesave dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ANEKS 1
GJENDJA E APLIKIMEVE PËR LEJE SHFRYTËZIMI NË RAPORT ME LEJET E NDËRTIMIT TË MIRATUARA GJATË VITEVE: 2000-2009

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi: Do të thotë që subjekti ka përfunduar të gjithë procedurën ligjore në bashki dhe dosja i është deleguar ZRPP-së për hipotekim.
- Në proces shqyrtimi: Do të thotë që subjekti është në proces ndërtimi, apo në fazën përfundimtare dhe nuk janë përfunduar të gjitha aktet e kontrollit.
- Ndërprerje procedurash: Është rasti kur subjekti nuk është interesuar për të vazhduar procedurat, aktet e kontrollit për t'u pajisur me lejen e shfrytëzimit për arsye të ndryshme. Subjekti mund të jetë larguar nga vendi, mund të ketë falimentuar, etj.
- Legalizim: Do të thotë që subjekti ka aplikuar pranë agjencisë së ALUIZNI-it me shpresë që procedura do të zgjasë më pak dhe për të legalizuar shtesat e kateve që mund të jenë realizuar.
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi: Subjektet në këtë rast kanë marë lejen e ndërtimit në bashki, por nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi.

Viti – 2001 - janë miratuar 91 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	29	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	0	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	7	aplikime;
- Legalizim:	22	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	33	subjekte.

Viti – 2002 - janë miratuar 91 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	37	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	5	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	7	aplikime;
- Legalizim:	10	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	32	subjekte.

Viti – 2003 - janë miratuar 104 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	52	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	4	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	5	aplikime;
- Legalizim:	17	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	26	subjekte.

Viti – 2004 - janë miratuar 99 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	54	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	4	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	12	aplikime;
- Legalizim:	4	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	25	subjekte.

Viti – (2003-2004) - janë miratuar 203 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	106	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	8	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	17	aplikime;
- Legalizim:	21	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	51	subjekte.

Viti -2005 – janë miratuar 120 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	47	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	8	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	11	aplikime;
- Legalizim:	8	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	46	subjekte.

Viti – 2006 - janë miratuar 56 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	14	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	11	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	1	aplikim;
- Legalizim:	0	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	30	subjekte.

Viti – 2007 – janë miratuar 5 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	1	aplikim;
- Në proces shqyrtimi:	0	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	0	aplikime;
- Legalizim:	0	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi	4	subjekte.

Viti – 2008 – janë miratuar 89 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	19	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	8	aplikime;
- Ndërprerje procedurash:	0	aplikime;
- Legalizim:	0	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	62	subjekte.

Viti – 2009 – janë miratuar 25 leje ndërtimi;

Respektivisht nga të cilat:

- Janë pajisur me leje shfrytëzimi:	3	aplikime;
- Në proces shqyrtimi:	1	aplikim;
- Ndërprerje procedurash:	0	aplikime;
- Legalizim:	0	aplikime;
- Nuk kanë aplikuar për leje shfrytëzimi:	21	subjekte.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	328 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 9.11.2011
Doli nga shtypi më 10.11.2011

Tirazhi: 1700 copë	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja Mediaprint
Tiranë, 2011

Çmimi 48 lekë